REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 6866/7 Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 556, datë 28.10.2025

PËR

MIRATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE TË DISA LËNDËVE TË KURRIKULËS BËRTHAMË DHE TË KURRIKULËS ME ZGJEDHJE, TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës "ç", të pikës 2, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të shkronjave "dh" dhe "e", të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)" dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës "Gjuhë shqipe", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Letërsi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë angleze", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës "Qytetari", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

5. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Histori", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
6. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjeografi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
7. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Muzikë", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
8. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Art pamor", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
9. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Teatër", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
10. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
11. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Matematikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 11 , bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
12. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Fizikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 12, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
13. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Kimi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 13, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
14. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Biologji", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 14, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
15. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 15, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
16. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë dhe klasën e dymbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 16, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
17. Programet mësimore të klasës së dhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2026 – 2027.
18. Programet mësimore të klasës së njëmbëdhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2027 – 2028.
19. Programet mësimore të klasës së dymbëdhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2028 – 2029.
20. Programet mësimore të mëparshme, shfuqizohen sipas fillimit të zbatimit të programeve mësimore të lëndëve në klasat e sipërcituara.

21. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E ARSIMIT

ASCAP

ASCAP
Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

PROGRAMI I LËNDËS "HISTORI"
ARSIMI I MESËM I LARTË
KLASA 10

FUSHA "SHKENCAT SHOQËRORE"

PROGRAM I PËRDITËSUAR

Koordinator: Ines Todhe

www.ascap.edu.al

2025

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

1 HYRJE 4

2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS 5

2.1 OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS SË HISTORISË NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË 5

3 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT 7

3.1 KOMPETENCAT KYÇE DHE REZULTATET E TË NXËNIT 12

3.2 TEMAT NDËRKURRIKULARE DHE LIDHJA ME LËNDËN E HISTORISË 16

3.3 REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT DHE KONCEPTET KYÇE TË LËNDËS SË HISTORISË 19

4 PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT 31

4.1 KOHA MËSIMORE PËR SECILËN TEMATIKË PËR KLASËN E DHJETË 32

4.2 PËRMBAJTJA E KLASËS SË DHJETË 32

4.2.1 Tematika: Qytetërimi antik Grek dhe Romak 34

4.2.2 Tematika: Qytetërimet botërore në mesjetë 37

4.2.3 Tematika: Qytetërimet në fillimet e historisë moderne 43

4.2.4 Tematika: Koha e ndryshimeve thelbësore 47

4.2.5 Tematika: Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945) 52

4.2.6 Tematika: Qytetërimet bashkëkohore (1945 – sot) 60

4.3 QËNDRIME DHE VLERA 70

5 METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES 71

5.1 ROLI I SITUATAVE TË TË NXËNIT PRAKTIKE NGA JETA REALE NË MËSIMIN E HISTORISË 74

5.2 ROLI I VEPRIMTARIVE PRAKTIKE DHE PROJEKTEVE KURRIKULARE NË LËNDËN E HISTORISË 76

5.2.1 Shembull i një veprimtarie praktike për klasën X 77

5.2.2 Shembull i një projekti në klasën X 81

5.3 PUNA ME NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA NË LËNDËN E HISTORISË 83

6 VLERËSIMI I NXËNËSVE 84

6.1 SHEMBUJ TË NIVELEVE TË ARRITJES PËR VLERËSIMIN E REZULTATEVE TË TË NXËNIT, RN-VE 89

7 BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE 90

8 PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SI MJET DHE TEKNIKË MËSIMORE NË LËNDËN E HISTORISË 90

9 REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT 92

9.1 SQARIM PËR VEPRIMTARITË PRAKTIKE TË SUGJERUARA DHE ORËT MËSIMORE TË DEDIKUARA PËR ZHVILLIMIN E TYRE 92

10 NDRYSHIMET E PROGRAMIT TË HISTORISË, KLASA X 96

10.1 PËRDITËSIME NË ASPEKTET PËRMBAJTJESORE TË LËNDËS SË HISTORISË 96

10.2 PËRDITËSIMET NË ASPEKTIN METODOLOGJIK 97

1 HYRJE

Lënda e historisë zë një vend të rëndësishëm në arsimin e mesëm të lartë, pasi ndihmon nxënësit të kuptojnë më thellë botën moderne përmes analizës së zhvillimeve të shoqërisë njerëzore ndër shekuj. Në këtë cikël, historia nuk shërben vetëm për të njohur të shkuarën, por për të zhvilluar aftësinë për të kuptuar proceset afatgjata që kanë ndikuar në formësimin e realitetit të sotëm kombëtar dhe ndërkombëtar. Studimi i ngjarjeve, figurave, ideve dhe periudhave historike u ofron nxënësve mundësinë për të ndërtuar një kuptim të rrjedhshëm, analitik dhe për të argumentuar të së kaluarës dhe për ta lidhur atë me sfidat e së tashmes.

Nëpërmjet kësaj lënde, nxënësit përvetësojnë njohuri dhe aftësi që i ndihmojnë të zhvillojnë mendim kritik dhe të pavarur. Ata mësojnë të analizojnë burime historike, të dallojnë midis fakteve dhe interpretimeve, të formulojnë pyetje hulumtuese dhe të ndërtojnë argumente të bazuara. Këto aftësi i pajisin me mjetet e nevojshme për të kuptuar marrëdhëniet komplekse shkak-pasojë dhe për të ndërtuar qëndrime të balancuara, të mbështetura në evidencë dhe logjikë.

Përmes hulumtimit, interpretimit dhe komunikimit të ideve, nxënësit ndërveprojnë me një gamë të gjerë materialesh historike: tekste, harta, dokumente, ilustrime, kronologji dhe burime pamore. Kjo përvojë mbështet ndërtimin e një kuptimi të thelluar dhe të ndërthurur të përmbajtjes historike, duke i ndihmuar ata të lidhin ngjarjet, idetë dhe proceset përtej kohës dhe hapësirës. Metodologjitë e mësimdhënies të bazuara në diskutim, punë në grup dhe analizë shumë perspektivash nxisin bashkëpunimin, zhvillimin e përgjegjësisë kolektive dhe respektin për mendimin ndryshe.

Historia kontribuon në formimin e një identiteti të qëndrueshëm personal, kulturor dhe kombëtar, duke forcuar ndjenjën e përkatësisë, ndërgjegjen historike dhe patriotizmin e informuar. Njohja e trashëgimisë kulturore dhe e rrënjëve historike shqiptare është thelbësore për të kuptuar rolin dhe vendin e Shqipërisë në kontekstin e historisë botërore.

Në këtë kuadër, historia në arsimin e mesëm të lartë nuk trajtohet vetëm si një koleksion faktesh, por si një mënyrë të menduari që u mundëson nxënësve të kuptojnë më mirë botën ku jetojnë. Ajo synon të formojë individë të ditur, logjikë, të ndjeshëm dhe të aftë për të marrë vendime të informuara, për të reflektuar mbi të kaluarën dhe për të kontribuar në mënyrë të ndërgjegjshme në shoqërinë e sotme dhe të së nesërmes.

2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS

Qëllimi i mësimit të historisë në arsimin e mesëm të lartë është të ndihmojë nxënësit të kuptojnë në mënyrë të thelluar zhvillimet historike që kanë ndikuar në formimin e botës moderne dhe të zhvillojnë një vizion të qartë e kritik mbi të kaluarën, për të marrë vendime të informuara në të tashmen dhe të ardhmen. Historia në këtë nivel synon të forcojë aftësinë e nxënësve për të analizuar ngjarjet dhe proceset historike me thellësi konceptuale, për të kuptuar kompleksitetin e marrëdhënieve njerëzore ndër vite, si dhe për të vepruar si qytetarë të informuar dhe të përgjegjshëm në një shoqëri demokratike dhe botë të ndërlidhur globalisht.

Përmes programit të historisë në këtë cikël, nxënësit nxiten të zhvillojnë mendimin kritik, të analizojnë burime të shumta e të larmishme, të ndërtojnë argumente të mbështetura në fakte, si dhe të vlerësojnë ndikimin e së shkuarës në ndërtimin e identitetit të tyre personal, kulturor, kombëtar dhe evropian. Mësimi i historisë forcon gjithashtu kompetencat për kërkim të pavarur, për të menduar në mënyrë analitike dhe për të ndërvepruar me perspektiva të ndryshme kulturore dhe historike.

2.1 Objektivat e përgjithshme të lëndës së historisë në arsimin e mesëm të lartë

Programi i historisë lidh vlerat e të mësuarit të historisë me qëllimet e arsimit parauniversitar, me kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe Rekomandimet Rek (2001)15 të Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare, për mësimdhënien e historisë në shekullin XXI, duke ndërtuar tek nxënësi konceptet dhe kompetencat historike. *Në përfundim të arsimit të mesëm të lartë, nxënësi pritet që:*

- ✓ të interpretojë në mënyrë të argumentuar zhvillimet kryesore të historisë kombëtare dhe botërore, duke shqyrtuar ndërveprimin ndërmjet qytetërimeve dhe ndikimet reciproke të tyre në kontekste të ndryshme historike.
- ✓ të analizojë lidhjet shkak–pasojë ndërmjet fenomeneve historike, duke reflektuar mbi pasojat afatgjata të ngjarjeve dhe ideve që kanë formuar shoqëritë bashkëkohore;
- ✓ të dallojë dhe të krahasojë qëndrime të ndryshme historike, për të kuptuar se historia është e ndikuar nga interpretimi, konteksti dhe perspektiva;

- ✓ të vlerësojë saktësinë, besueshmërinë dhe qëllimin e burimeve të ndryshme historike (tekstuale, pamore, gojore, digjitale), duke i përdorur ato në mënyrë të vetëdijshme dhe kritike;
- ✓ të ndërtojë argumente historike të mbështetura në evidencë, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të komunikimit (ese, debate, prezantime vizuale dhe digjitale);
- ✓ të zhvillojë njohuri për konceptet themelore të analizës historike si: kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia, shkaku dhe pasoja, përkufizimi i periudhave, konteksti, empatia historike dhe shumë perspektiviteti;
- ✓ të kuptojë ndikimin e ideve, lëvizjeve dhe ngjarjeve historike në zhvillimin e shteteve, institucioneve demokratike, të drejtave të njeriut dhe bashkëjetesës globale;
- ✓ të tregojë vetëdije të lartë për trashëgiminë kulturore kombëtare dhe botërore, si dhe të njohë përgjegjësinë për mbrojtjen dhe promovimin e saj në një kontekst të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës;
- ✓ të forcojë ndjenjën e përkatësisë dhe identitetit kulturor e kombëtar, në përputhje me parimet e qytetarisë demokratike dhe me vizionin evropian të integrimit dhe bashkëpunimit;
- ✓ të përdorë teknologjinë dhe mjetet digjitale në mënyrë të vetëdijshme dhe etike për kërkimin dhe prezantimin e informacionit historik, duke zhvilluar kompetenca për të nxënë në mënyrë të pavarur dhe bashkëkohore;
- ✓ të reflektojë në mënyrë kritike mbi rolin e të kaluarës në ndërtimin e së tashmes, duke përdorur njohuritë historike për të kuptuar më mirë sfidat dhe përgjegjësitë e një qytetari në një shoqëri globale;
- ✓ të zhvillojë aftësi për të punuar në mënyrë bashkëpunuese, për të respektuar mendime të ndryshme dhe për të ndërvepruar me kultura të tjera, duke ndërtuar një vizion të hapur dhe gjithëpërfshirës për botën;
- ✓ të forcojë kompetencat qytetare dhe ndjenjën e përgjegjësisë sociale, si përgatitje për jetën, punën dhe pjesëmarrjen aktive në një shoqëri demokratike.

3 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i historisë synon të krijojë kushte të favorshme për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave historike dhe atyre kyçe, duke u mbështetur në përmbajtje të pasur, në analiza kritike të ngjarjeve dhe burimeve, si dhe në ndërlidhjen e koncepteve historike me përvojat e jetës reale. Në thelb, ky program përqendrohet në formimin e nxënësve si individë të aftë për të kuptuar zhvillimin e shoqërisë njerëzore, për të interpretuar në mënyrë të përgjegjshme të kaluarën dhe për të ndërtuar qëndrime qytetare aktive në të tashmen dhe të ardhmen. Programi i lëndës së historisë në arsimin e mesëm të lartë përfshin:

- ***Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit që zhvillohen nëpërmjet lëndës së historisë.*** Lënda e historisë në arsimin e mesëm të lartë është konceptuar si mjet i fuqishëm formues, i cili shkon përtej transmetimit të njohurive faktike dhe shërben si platformë edukative për zhvillimin e mendimit kritik, reflektues dhe qytetar. Programi synon të krijojë kushte të favorshme për zhvillimin e kompetencave historike dhe atyre kyçe, nëpërmjet analizës së thelluar të ngjarjeve, burimeve dhe konteksteve historike, si dhe të ndërlidhjes së tyre me sfidat aktuale të shoqërisë. Përmes përmbajtjeve historike dhe metodologjive aktive, nxënësit formohen si qytetarë të informuar dhe të ndërgjegjësuar për zhvillimet politike, sociale dhe kulturore. Lënda kontribuon ndjeshëm në zhvillimin e të gjitha kompetencave kyçe të përcaktuara në Kornizën Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar. Nëpërmjet historisë, nxënësit arrijnë të strukturojnë argumente, të interpretojnë dukuritë në kontekste të ndryshme kohore dhe hapësinore, si dhe të vlerësojnë pasojat e tyre në jetën bashkëkohore. Mësimdhënia në histori kontribuon në ndërtimin e identitetit personal dhe kolektiv, si dhe në vetëdijen qytetare. Diskutimi i koncepteve si drejtësia, të drejtat e njeriut, toleranca, barazia dhe trashëgimia kulturore u jep nxënësve një kuadër të gjerë për të kuptuar dinamikat e shoqërisë bashkëkohore dhe për të kontribuar në mënyrë të vetëdijshme në të ardhmen e saj. Në këtë formë, historia bëhet jo vetëm një mjet i të nxënit, por edhe themel i qytetarisë aktive dhe i pjesëmarrjes në jetën demokratike.

📖 ***Temat ndërkurrikulare dhe zhvillimi i tyre nëpërmjet lëndës së historisë.*** Integrimi i temave ndërkurrikulare në lëndën e historisë (identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave, qytetaria aktive dhe sipërmarrja, shëndeti mendor, fizik dhe siguria, zhvillimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e mjedisit, si dhe teknologjia, shoqëria dhe media), përfaqëson një qasje strategjike për të thelluar të kuptuarit e proceseve historike dhe për të zhvilluar kompetenca komplekse, të ndërthurura me realitetin bashkëkohor. Këto tema i ofrojnë nxënësve mundësinë për të eksploruar mënyrën se si fenomenet shoqërore dhe kulturore janë formuar dhe transformuar ndër shekuj, si dhe për të analizuar në mënyrë kritike ndërveprimet ndërmjet historisë dhe sfidave moderne. Duke lidhur të kaluarën me çështje aktuale, nxënësit aftësohen të kontekstualizojnë informacionin historik dhe ta zbatojnë atë në situata konkrete të jetës qytetare. Përmes kësaj qasjeje, zhvillohen kompetenca historike si kërkimi, interpretimi i burimeve të ndryshme, ndërtimi i argumenteve të strukturuara dhe komunikimi efektiv në kontekste shumëdimensionale. Përveç përfitimit të njohurive historike, nxënësit ushqejnë ndjeshmërinë qytetare dhe përgjegjësinë sociale, duke e përjetuar historinë si një fushë që i orienton drejt pjesëmarrjes së informuar dhe të qëndrueshme të shoqërisë bashkëkohore.



📖 ***Kompetencat e lëndës dhe rezultatet e të nxënit.*** Lënda e historisë në arsimin e mesëm të lartë synon zhvillimin e kompetencave të lëndës (kërkimi historik; përdorimi i burimeve; analiza shkak-pasojë; interpretimi historik; shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën). Procesi mësimor është i ndërtuar për të forcuar këto kompetenca si: aftësia për të kërkuar dhe përpunuar informacion historik nga burime të ndryshme

(tekste, dokumente, dëshmi gojore, harta etj.);aftësia për të kuptuar dhe shpjeguar lidhjet shkak-pasojë në zhvillimin historik; aftësia për të analizuar dhe interpretuar perspektiva të ndryshme historike; aftësia për të shprehur në mënyrë të qartë dhe të argumentuar qëndrime lidhur me ngjarje apo fenomene historike. Një vend të rëndësishëm në procesin mësimor zë edhe zhvillimi i koncepteve kyçe të historisë, si: kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia, diversiteti, empatia historike dhe rëndësia historike e ngjarjeve apo e përvojave njerëzore. Këto kompetenca dhe koncepte ndihmojnë nxënësit të orientohen në një botë të mbingarkuar me informacion, ku aftësia për të dalluar burime të besueshme dhe për të kuptuar rrënjët historike të fenomeneve të sotme është thelbësore.

📖 ***Përmbajtja mësimore dhe rezultatet e të nxënit.*** Programi i historisë në arsimin e mesëm të lartë është ndërtuar mbi një strukturë kronologjike që mbulon periudhat kryesore të zhvillimit historik: parahistorinë, qytetërimet e lashta, mesjetën, epokën moderne dhe periudhën bashkëkohore. Përmbajtja trajtohet si në kontekstin botëror, ashtu edhe në atë shqiptar, duke i dhënë nxënësit mundësinë për të ndërtuar njohuri të balancuara dhe të lidhura me realitetin e tyre kombëtar e global. Struktura e programit paraqet në mënyrë të qartë tematikat përkatëse për çdo klasë, veprimtaritë praktike, shpërndarjen e orëve mësimore dhe rezultatet e pritshme të të nxënit për secilën tematikë. Theksi vendoset në zhvillimin e aftësive për të kërkuar, analizuar, interpretuar dhe argumentuar mbi ngjarjet dhe proceset historike, duke i vendosur ato në një kontekst më të gjerë shoqëror dhe kulturor. Përmes ballafaqimit me tema sfiduese dhe të debatueshme, nxënësit mësojnë të kuptojnë më mirë ndikimin e së kaluarës në zhvillimet e sotme dhe të reflektojnë mbi mësimet që historia mund të ofrojë për të ardhmen. Kjo qasje kontribuon në përgatitjen e nxënësve si individë të aftë të analizojnë dhe kuptojnë botën që i rrethon, si qytetarë të informuar dhe të angazhuar në një shoqëri demokratike.

📖 ***Metodologjia e mësimdhënies.*** Në lëndën e historisë është e domosdoshme përdorimi i metodave aktive dhe bashkëkohore të të nxënit, të cilat e vendosin nxënësin në qendër të procesit mësimor dhe e inkurajojnë atë të angazhohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me përmbajtjen historike. Ndër këto metoda përfshihen të mësuarit përmes burimeve historike, studimi i rasteve konkrete, puna në grup, debati i strukturuar, veprimtaritë praktike, dramatizimi i ngjarjeve, ndërtimi i linjës së kohës etj. Përdorimi i këtyre metodave synon jo vetëm përvetësimin e dijes faktike, por edhe zhvillimin e aftësive analitike, mendimit kritik, zgjidhjes së problemit, përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), empatisë historike dhe vetëdijes qytetare.

📖 ***Vlerësimi i nxënësve.*** Ndër format më të përdorura të vlerësimit përfshihen detyrat krijuese, veprimtaritë praktike, konkurset, esetë, projektet kërkimore individuale apo në grup, si dhe vetëvlerësimi nga ana e nxënësve, me qëllim nxitjen e reflektimit dhe ndërgjegjësimit mbi procesin e të nxënit. Këto forma vlerësimi nuk synojnë vetëm matjen e njohurive faktike, por edhe zhvillimin e aftësive analitike, të mendimit kritik, të shprehjes së ideve dhe të punës bashkëpunuese. Ato u japin nxënësve mundësinë të demonstrojnë kompetencat në mënyra të ndryshme, duke respektuar stilin e tyre individual të të nxënit dhe duke i inkurajuar të marrin një rol aktiv dhe të vetëdijshëm në procesin e vlerësimit.

📖 ***Burimet dhe materialet didaktike.*** Përdorimi i burimeve të shumëllojshme si: tekste, harta historike, fotografi, objekte muzeale, dokumente arkivore, platforma digjitale dhe dokumentarë, është thelbësor për të nxitur interesin dhe angazhimin e nxënësve në procesin e të nxënit. Këto burime ndihmojnë në konkretizimin e ngjarjeve dhe proceseve historike, duke i bërë ato më të kuptueshme dhe më afër përvojës së nxënësit. Ato shërbejnë gjithashtu si bazë për zhvillimin e aftësive të kërkimit, analizës, interpretimit dhe mendimit kritik. Teknologjia, në këtë kontekst, përdoret si mjet mbështetës për kërkimin e informacionit, vizualizimin e periudhave historike dhe prezantimin e njohurive të fituara. Ajo u ofron nxënësve mundësi për të eksploruar përmes mjeteve interaktive, duke nxitur pjesëmarrjen aktive dhe ndërtimin e një kuptimi më të pasur dhe reflektues për të kaluarën.

📖 ***Rekomandime për zbatimin e programit.*** Në këtë rubrikë jepen udhëzime të posaçme për mësuesit, hartuesit e teksteve dhe vlerësuesit, me synimin për të siguruar që përmbajtja mësimore dhe veprimtaritë e sugjeruara praktike të përshtaten në mënyrë të plotë me nevojat, interesat dhe nivelin e zhvillimit të nxënësve. Rekomandimet theksojnë domosdoshmërinë për të zbatuar një qasje të ndjeshme dhe të balancuar ndaj përmbajtjes historike, duke marrë parasysh larminë kulturore dhe kontekstin shoqëror në të cilin zhvillohet mësimi. Në veçanti, theksohet rëndësia e lidhjes mes historisë dhe lëndëve të tjera të kurrikulës së AML-së, për të forcuar kuptimin e ndërlidhur të dijes. Po ashtu, inkurajohet përdorimi i metodave që promovojnë mendimin kritik, ndjeshmërinë qytetare, empatinë historike dhe ndërgjegjësimin për identitetin kulturor dhe kombëtar, me qëllim formimin e nxënësve si qytetarë të ndërgjegjshëm, aktivë dhe të përgjegjshëm.

📖 ***Ndryshimet e programit.*** Kjo rubrikë përshkruan përditësimet kryesore të ndërmarra në programin e historisë, me qëllim përmbushjen e synimeve kombëtare të arsimit parauniversitar dhe forcimin e qasjes bazuar në kompetenca. Ndryshimet kanë për qëllim të ofrojnë një përmbajtje dhe metodologji më të përshtatshme dhe të balancuar për zhvillimin e mendimit kritik dhe kompetencave historike tek nxënësit,

në përputhje me kërkesat e një shoqërie demokratike të ndërlidhur globalisht. Përditësimet përqendrohen në rëndësinë që historia duhet t'i kushtojë trajtimit të zhvillimeve të reja shoqërore, ndryshimeve klimatike dhe mjedisore, zhvillimit të qëndrueshëm dhe nevojës për bashkëjetesë paqësore në një botë gjithnjë e më komplekse. Programi i përditësuar përfshin tema ose veprimtari që trajtojnë ndjenjën e patriotizmit, identitetin kombëtar, pakicat kombëtare, trashëgiminë kulturore dhe ndikimet ndërkulturore. Njëkohësisht, ai nxit ndërgjegjësimin për diversitetin, bashkëjetesën dhe dialogun ndërkulturor, si elemente themelore të edukimit për jetesën në një shoqëri të hapur, gjithëpërfshirëse dhe demokratike. Vëmendje i kushtohet edhe trajtimit të çështjeve që lidhen me rreziqet natyrore, pandemitë, si dhe krizat ekonomike dhe politike, duke theksuar mënyrën se si historia ndihmon në kuptimin dhe përballimin e sfidave bashkëkohore. Një vend të veçantë në program zë gjithashtu trajtimi i rolit të zhvillimeve teknologjike në transformimin e jetës shoqërore dhe të realitetit bashkëkohor, si në të tashmen ashtu edhe në perspektivën e ardhshme. Këto përditësime e bëjnë programin më gjithëpërfshirës dhe më të përditësuar, duke e harmonizuar me rekomandimet e Këshillit të Evropës për mësimdhënien e historisë në shekullin XXI. Në këtë mënyrë, programi synon të përgatisë nxënësit për një qytetari aktive, kritike dhe të ndërgjegjshme në një botë dinamike dhe në ndryshim të vazhdueshëm.

KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA

3.1 Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit

Zhvillimi i kompetencave kyçe përmes mësimit të historisë në arsimin e mesëm të lartë kërkon që mësuesi të ndërtojë lidhje të qëndrueshme ndërmjet kompetencave kyçe dhe atyre specifike të lëndës së historisë, të përshtatura sipas niveleve të klasave. Kjo nënkupton një planifikim të kujdesshëm të situatave të të nxënit dhe veprimtarive praktike, përzgjedhjen e metodave bashkëkohore të mësimdhënies si dhe krijimin e kushteve që nxisin angazhimin aktiv të nxënësve, mendimin kritik dhe zbatimin e njohurive në kontekste të ndryshme. Kompetenca përkufizohet si një ndërthurje e qëndrueshme dhe e balancuar ndërmjet njohurive, aftësive, qëndrimeve, vlerave dhe mendimit kritik, që i mundëson nxënësit të veprojë në mënyrë të pavarur dhe të efektshme në situata reale dhe të ndërlikuara. Qasja e mësimdhënies, e mbështetur në zhvillimin e kompetencave, zhvendos fokusin nga mësuesi tek nxënësi, duke kaluar nga përvetësimi pasiv i informacionit në ndërtimin aktiv të kuptimit. Në këtë qasje, historia nuk paraqitet vetëm si një sërë faktesh për t'u mësuar, por si një mjet për të kuptuar botën, për të reflektuar mbi të kaluarën dhe për të ndërmarrë veprime të përgjegjshme në të tashmen. Rezultatet e të nxënit që lidhen me zhvillimin e kompetencave kyçe përmes lëndës së historisë në këtë cikël përfshijnë: aftësinë për të hulumtuar dhe analizuar burime historike; për të ndërtuar argumente të mbështetura në prova; për të identifikuar lidhje ndërmjet së kaluarës dhe sfidave të sotme; për të respektuar perspektiva të ndryshme dhe për të kontribuar në ndërtimin e një qëndrimi qytetar të ndërgjegjshëm. Rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe që mund të zhvillojë nxënësi *në arsimin e mesëm të lartë* në lëndën e historisë mund të përmblidhen si më poshtë:

Tabela 1. Kompetencat kyç dhe rezultatet e të nxënit

Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare	Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhën amtare, nxënësi: - përdor gjuhë të saktë, të qartë dhe të pasur për të treguar, përshkruar dhe analizuar ngjarje, figura dhe procese historike;	*Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhë të huaj, nxënësi:* - njeh dhe përdor në mënyrë të saktë terma dhe koncepte historike në gjuhë të huaj, veçanërisht në kontekstin e temave me përmasa ndërkombëtare;

- ndërton dhe paraqet argumente historike në formë gojore dhe të shkruar, duke i strukturuar në mënyrë logjike dhe të qëndrueshme; - merr pjesë në diskutime historike, duke dëgjuar me vëmendje dhe respektuar mendimet e të tjerëve; - përpunon informacionin nga burime të ndryshme historike dhe e organizon atë në mënyrë të qartë, të saktë dhe koherente; - përdor fjalorin historik në mënyrë të vetëdijshme për të komunikuar mendimet dhe për të kuptuar përmbajtjen mësimore.	- përfshihet në diskutime të strukturuara mbi ngjarje dhe procese historike me rëndësi globale, duke përdorur fjalor të përshtatshëm; - përdor materiale burimore dhe ndihmëse në gjuhë të huaj (tekste, artikuj, video, platforma edukative) për të zgjeruar dhe thelluar njohuritë historike; - prezanton projekte, ide ose fakte historike në gjuhë të huaj përmes mjeteve digjitale, formave të komunikimit elektronik dhe bashkëpunimit virtual ndërkulturor.
Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri	**Kompetenca digjitale**
Për të dëshmuar kompetencat në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri, nxënësi: - kupton dhe analizon ndikimin e zhvillimeve shkencore dhe teknologjike në rrjedhën e historisë dhe në ndryshimet shoqërore; - lidh zbulimet shkencore, shpikjet dhe përparimet teknologjike me kontekstet historike ku ato kanë ndodhur, duke vlerësuar ndikimin e tyre në zhvillimin e epokave të caktuara; - analizon mënyrën si përparimet teknologjike kanë ndikuar në jetesën, ekonominë dhe marrëdhëniet shoqërore në periudha të ndryshme historike; - përdor harta, grafikë, tabela dhe skema për të paraqitur të dhëna dhe zhvillime historike në mënyrë të argumentuar dhe logjike.	*Për të dëshmuar kompetencën digjitale, nxënësi:* - përdor burime digjitale (faqe zyrtare, arkiva online, platforma mësimore) për të kërkuar, përzgjedhur dhe analizuar informacion historik me qëllim formësimin e një kuptimi të bazuar në të dhëna; - krijon prezantime, video apo materiale të tjera vizuale për të komunikuar përmbajtje historike në mënyrë kreative dhe të qartë; - menaxhon burimet e informacionit në mënyrë të sigurt dhe etike, duke respektuar të drejtat e autorit dhe normat e përdorimit të të dhënave; - përdor teknologjinë për të ndërtuar linja kohore, për të analizuar dokumente historike dhe për të paraqitur zhvillime historike në mënyrë vizuale dhe interaktive;

	- përdor mjete të inteligjencës artificiale për të analizuar dhe interpretuar të dhëna, për të krijuar përmbajtje të re dhe për të zgjidhur probleme historike në mënyrë të arsyetuar; - bashkëpunon me bashkëmoshatarët nëpërmjet platformave digjitale për të zhvilluar projekte, për të ndarë ide dhe për të zgjidhur çështje të lidhura me temat historike.
Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit	**Kompetenca qytetare**
Për të dëshmuar kompetencën personale, shoqërore dhe të nxënies, nxënësi: - reflekton mbi procesin e të nxënit dhe përmirëson strategjitë personale për të arritur qëllime të caktuara; - punon në mënyrë të pavarur dhe bashkëpunon në grup për të planifikuar dhe zhvilluar projekte historike; - negocion dhe zgjidh konflikte në mënyrë konstruktive, menaxhon stresin dhe situatat sfiduese me vetëkontroll; - vlerëson rëndësinë e një jetese të shëndetshme dhe praktikon zakone të mira ushqimore dhe fizike; - shpreh dëshirë për të mësuar gjatë gjithë jetës dhe angazhohet në bashkëpunim të ndërsjellë me të tjerët; - demonstron ndjeshmëri dhe respekt për përvojat historike të komuniteteve të ndryshme dhe për kulturat e tjera;	*Për të dëshmuar kompetencën qytetare, nxënësi:* - njeh të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në shoqëri, duke u bazuar në përvoja dhe zhvillime historike; - demonstron respekt për historinë kombëtare dhe trashëgiminë kulturore të vendit; - vlerëson diversitetin kulturor, etnik dhe fetar me tolerancë, mirëkuptim dhe respekt; - demonstron vlerat themelore të të drejtave të njeriut, si respekti për dinjitetin personal, barazinë dhe lufta kundër çdo forme diskriminimi; - analizon rolin e individëve dhe grupeve shoqërore në procese historike që kanë ndikuar në zhvillimet politike dhe qytetare; - merr pjesë në diskutime që lidhen me temat historike që trajtojnë të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, drejtësinë shoqërore dhe paqen;

- përvetëson qëndrime të përgjegjshme dhe të vetëdijshme në raport me historinë, trashëgiminë dhe ndikimin e saj në të tashmen; - identifikon dhe përmirëson aftësitë, dobësitë dhe prioritetet personale në mënyrë të qëllimshme; - organizon procesin e të nxënit, vendos qëllime të arritshme dhe vlerëson punën dhe përparimin e tij; - motivon dhe vlerëson veten, duke kontribuar me përgjegjësi si në punë individuale ashtu edhe në grup; - analizon situata me ngarkesë emocionale ose sociale dhe propozon zgjidhje pozitive e të qëndrueshme.	- tregon solidaritet dhe ndihmon në zgjidhjen e problemeve që prekin komunitetin shkollor apo më gjerë; - menaxhon konfliktet në mënyrë të drejtë, konstruktive dhe të paanshme; - demonstron sjellje etike ndaj mjedisit dhe angazhohet për mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë e tij; - reagon ndaj shkeljeve të të drejtave të të tjerëve dhe analizon pasojat që sjell mungesa e drejtësisë dhe barazisë; - njeh kontributin dhe sfidat historike të pakicave kombëtare dhe komuniteteve të margjinalizuara, duke zhvilluar ndjeshmëri qytetare dhe qëndrime gjithëpërfshirëse.
Kompetenca e sipërmarrjes	**Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore**
Për të dëshmuar kompetencën e sipërmarrjes, nxënësi: - planifikon dhe zhvillon projekte historike që lidhen me ngjarje, figura ose trashëgimi kulturore, duke ndjekur një qasje të strukturuar dhe të qëndrueshme; - demonstron kreativitet dhe aftësi për të propozuar zgjidhje inovative në trajtimin e temave historike dhe në paraqitjen e tyre; - përfshihet në organizimin e aktiviteteve shkollore apo komunitare, si ekspozita, dramatizime, debate ose fushata ndërgjegjësuese mbi tema me rëndësi historike;	*Për të dëshmuar kompetencën për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, nxënësi:* - njeh dhe vlerëson trashëgiminë kulturore materiale dhe jo materiale, si në kontekstin shqiptar ashtu edhe në atë botëror, duke zhvilluar ndjeshmëri për vlerat historike dhe identitare; - shpreh mendime, ndjesi dhe qëndrime në lidhje me figura, ngjarje apo simbole historike përmes mjeteve të ndryshme artistike dhe krijuese (ese, poezi, ilustrime, video, dramë, etj.);

- përdor në mënyrë të efektshme burime, mjete dhe teknologji për të realizuar nisma me përmbajtje historike apo ndërdisiplinore; - punon në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me të tjerët për të nxitur zhvillimin personal dhe atë të komunitetit; - analizon ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedis gjatë historisë dhe organizon aktivitete që promovojnë mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë mjedisore; - përdor materiale të ndryshme dhe teknologji bashkëkohore për të përmirësuar procesin e të nxënit dhe për të orientuar zgjedhjet në karrierë në mënyrë të vetëdijshme dhe krijuese; - identifikon lidhjet ndërmjet njohurive historike, aftësive personale dhe mundësive të zhvillimit profesional, duke reflektuar mbi rolin e interesave dhe vlerave në planifikimin e karrierës.	- merr pjesë në veprimtari që promovojnë ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, si pjesë e përgjegjësisë qytetare dhe angazhimit komunitar; - interpreton dhe ripërpunon ngjarje historike nëpërmjet ekspozitave, dramatizimeve, rrëfimeve gojore, punimeve vizuale apo digjitale, duke përzgjedhur forma shprehjeje që përcjellin mesazhe të qarta dhe të qëndrueshme; - vlerëson rolin e kulturës në ndërtimin e identitetit personal dhe kolektiv, dhe kontribuon në ruajtjen e diversitetit kulturor si pasuri për të tashmen dhe të ardhmen.

3.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e historisë

Integrimi i temave ndërkurrikulare në lëndën e historisë u mundëson nxënësve të zhvillojnë një kuptim më të thelluar dhe të ndërlidhur të zhvillimeve njerëzore dhe shoqërore në kohë dhe hapësirë. Përmes kësaj qasjeje, nxënësit lidhen më lehtësisht me realitetin bashkëkohor, duke reflektuar mbi mënyrën si ngjarjet dhe përvojat historike ndikojnë në sfidat e sotme dhe të ardhmes. Këto tema ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave historike si kërkimi, interpretimi, mendimi kritik, argumentimi dhe komunikimi, të gjitha të ndërlidhura me një qasje qytetare, demokratike dhe të qëndrueshme ndaj botës. Në këtë mënyrë, historia nuk shërben vetëm për të kuptuar të kaluarën, por edhe për të formuar qytetarin e së ardhmes, një individ të aftë për të reflektuar mbi kompleksitetin e botës moderne, për të bashkëjetuar në një shoqëri të ndërvarur dhe për të kontribuar në ndërtimin e një komuniteti më të drejtë, më të qëndrueshëm dhe më gjithëpërfshirës. Gjatë trajtimit të këtyre temave, nxënësi

angazhohet në zgjidhjen e situatave konkrete, përdor aftësitë e mendimit kritik dhe krijues, si dhe vë në zbatim kompetencat historike për të shpjeguar, argumentuar dhe parashtruar perspektiva mbi çështje me rëndësi të gjerë.

- ***Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.*** Lënda e historisë luan një rol thelbësor në ndërtimin e identitetit kombëtar, kulturor dhe ndërkulturor të nxënësit. Përmes njohjes së figurave historike, ngjarjeve formuese dhe trashëgimisë kulturore, si materiale ashtu edhe shpirtërore, nxënësi ndërton vetëdijen për përkatësinë e tij dhe rolin që zë si pjesë e komunitetit kombëtar dhe shoqërisë më të gjerë. Analiza e dokumenteve historike, simboleve, artefakteve dhe rrëfimeve nga kultura të ndryshme ndihmon në formimin e një identiteti personal dhe kolektiv të balancuar, të vetëdijshëm dhe të ndjeshëm ndaj diversitetit. Në këtë kuadër, historia kontribuon në njohjen dhe vlerësimin e kontributit të pakicave kombëtare dhe komuniteteve të tjera etnokulturore, si pjesë e pandashme e historisë dhe trashëgimisë së përbashkët. Përmes studimit të marrëdhënieve ndërmjet qytetërimeve, të shkëmbimeve kulturore dhe ndikimeve reciproke, nxënësi zhvillon respekt dhe mirëkuptim për kulturat e tjera. Ky proces përforcon ndjeshmërinë ndërkulturore dhe aftësinë për të bashkëjetuar në një shoqëri të larmishme, të hapur, gjithëpërfshirëse dhe demokratike.
- ***Qytetaria aktive dhe sipërmarrja***. Historia i ofron nxënësit një kuadër të pasur për të kuptuar konceptin e qytetarisë aktive dhe për të zhvilluar ndjenjën e përgjegjësisë shoqërore. Përmes studimit të institucioneve historike, modeleve të qeverisjes, lëvizjeve për të drejtat e njeriut dhe transformimeve shoqërore, nxënësi mëson se si qytetarët e angazhuar kanë ndikuar në zhvillimin e shoqërive më të drejta dhe më përfshirëse. Duke analizuar shembuj konkretë nga historia ku individët apo grupet kanë ndërmarrë iniciativa për ndryshim, nxënësi kupton rëndësinë e pjesëmarrjes aktive, bashkëpunimit dhe solidaritetit në jetën publike. Kjo ndihmon në formimin e qëndrimeve pro aktive dhe sipërmarrëse, jo vetëm në fushën ekonomike, por edhe në kontekste kulturore, sociale dhe qytetare, si kontribute për ndërtimin e një komuniteti më të përgjegjshëm dhe gjithëpërfshirës.
- ***Shëndeti mendor, fizik dhe siguria.*** Lënda e historisë ndihmon nxënësin të kuptojë se konceptet e shëndetit, higjienës, mbrojtjes fizike dhe mirëqenies mendore kanë evoluar në periudha të ndryshme historike dhe kanë ndikuar në zhvillimin e shoqërive. Nëpërmjet studimit të kushteve të jetesës, trajtimit të sëmundjeve, përkujdesjes shëndetësore dhe zakoneve të jetesës në kohë të ndryshme, nxënësi reflekton mbi rëndësinë e shëndetit si të drejtë universale dhe si faktor i stabilitetit shoqëror. Ai mëson të vlerësojë ndikimin e krizave shëndetësore në

rrjedhën e historisë (si pandemia e murtajës, gripi spanjoll, COVID-19), si dhe të ndërgjegjësohet për rolin e kujdesit ndaj vetes dhe komunitetit në historinë njerëzore

- ***Zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore.*** Përmes historisë, nxënësi kupton se marrëdhënia ndërmjet njeriut dhe mjedisit ka qenë një faktor përcaktues për zhvillimin ose rënien e shumë qytetërimeve. Ai mëson të analizojë se si mënyrat e jetesës, prodhimit dhe konsumit kanë ndikuar në shfrytëzimin ose ruajtjen e burimeve natyrore dhe të ambientit. Shembuj historikë si shpyllëzimi masiv, ndotja industriale, rrënimi i tokave bujqësore, apo përhapja e sëmundjeve për shkak të kushteve mjedisore të këqija, i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë pasojat afatgjata të veprimeve njerëzore. Në mënyrë të veçantë, historia shërben si mjet për të kuptuar origjinat dhe përshkallëzimin e krizës së ngrohjes globale, nëpërmjet analizës së Revolucionit Industrial, zhvillimit të transportit dhe industrive ndotëse, si dhe rritjes së konsumit në shekujt XX–XXI. Nxënësi ndërton vetëdijen se ngrohja globale nuk është një fenomen i shkëputur nga rrjedha historike, por një pasojë e drejtpërdrejtë e zgjedhjeve të bëra ndër shekuj. Përmes kësaj teme, nxënësi inkurajohet të reflektojë mbi domosdoshmërinë e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përgjegjësie ndër breznore, duke vlerësuar shembuj pozitivë e negativë nga historia dhe duke menduar në mënyrë kritike për rolin që mund të luajë sot në ruajtjen e mjedisit dhe në ndërtimin e një të ardhmeje më të qëndrueshme për të gjithë.
- ***Teknologjia, shoqëria dhe media.*** Lënda e historisë në arsimin e mesëm të lartë ofron një këndvështrim të thelluar mbi mënyrën se si zhvillimet teknologjike dhe mjetet e komunikimit kanë ndikuar në ndryshimet shoqërore ndër shekuj. Nga shpikja e shtypshkronjës, te ndikimi i radios dhe televizionit, e deri te përhapja e internetit dhe rrjeteve sociale, nxënësi mëson të analizojë sesi është shpërndarë informacioni, si janë ndërtuar narrativat publike dhe si është përdorur media për të ndikuar në mendimin shoqëror, politik dhe kulturor. Nëpërmjet përmbajtjes historike dhe analizës së burimeve, nxënësi zhvillon aftësi për të shqyrtuar në mënyrë kritike burimet mediatike si historike, ashtu edhe bashkëkohore, duke identifikuar qëllimin, perspektivën dhe besueshmërinë e tyre. Kjo e ndihmon të kuptojë rëndësinë e informacionit të verifikuar në ndërtimin e një opinioni të argumentuar dhe në formimin e një shoqërie të informuar, demokratike dhe të përgjegjshme. Historia kontribuon në edukimin e nxënësit si qytetar kritik në epokën digjitale, të aftë për të dalluar manipulimin e informacionit dhe për të vlerësuar ndikimin e teknologjisë në jetën sociale dhe politike të së kaluarës dhe të sotmes.

Veprimtaritë praktike të zhvillimit të temave ndërkurrikulare mund të përshkruhen në udhëzuesit kurrikularë lëndorë.

3.3 Rezultatet e të nxënit për kompetencat dhe konceptet kyçe të lëndës së historisë

Lënda e historisë në arsimin e mesëm të lartë synon thellimin e zhvillimit të kompetencave të lëndës: *kërkimi historik; përdorimi i burimeve; analiza shkak-pasojë; interpretimi historik; shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën dhe të koncepteve kyçe historike: kuptimi kronologjik; ndryshimi dhe vazhdimësia; diversiteti ;empatia historike; rëndësia historike.* Këto kompetenca zbërthehen në rezultate të nxëni si më poshtë.

Tabela 2: Kompetencat historike dhe rezultatet e të nxënit

Kompetencat historike që zhvillohen përmes tematikave	Përshkrimi i kompetencave	Rezultatet e të nxënit për kompetencat për klasën e dhjetë
Kërkimi historik	Kërkimi historik në arsimin e mesëm të lartë përfshin aftësinë për të formuluar pyetje komplekse historike, për të ndërtuar hipoteza të argumentuara dhe për të përdorur një gamë të gjerë burimesh për të hulumtuar ngjarje, procese dhe fenomene historike. Nxënësi mëson të vlerësojë natyrën, qëllimin dhe besueshmërinë e burimeve, të krahasojë perspektiva të ndryshme dhe të përdorë metoda kërkimore për të ndërtuar interpretime të mbështetura në të dhëna. Gjatë këtij procesi, ai zhvillon aftësi për të argumentuar në mënyrë të pavarur, për të sintetizuar	Nxënësi: ➢ formulon pyetje kërkimore që lidhen me ngjarje, figura dhe procese komplekse historike në kontekste të ndryshme kohore dhe gjeografike (p.sh., ndikimi i Revolucionit Industrial në strukturat sociale, roli i ideologjive në konfliktet e shekullit XX); ➢ përzgjedh dhe përdor burime të ndryshme (dokumete historike, burime gojore, statistika, artikuj shkencorë, media e epokës) për të hulumtuar temën e zgjedhur; ➢ analizon në mënyrë kritike përmbajtjen, qëllimin dhe kontekstin e burimeve historike, duke identifikuar anshmëri dhe kufizime;

	informacion dhe për të reflektuar në mbi ndikimin e historisë në shoqërinë bashkëkohore.	➢ ndërton një argument të bazuar në prova përmes eseve historike, prezantimeve ose projekteve kërkimore, duke përdorur fjalor të specializuar dhe një strukturë të qartë logjike; ➢ reflekton mbi mënyrën se si e kaluara lidhet me sfidat bashkëkohore dhe propozon mënyra për ta kuptuar apo adresuar ndikimin e saj në shoqërinë e sotme.
Përdorimi i burimeve	Njohja e së kaluarës historike ndërtohet mbi përdorimin kritik dhe të argumentuar të burimeve historike. Këto burime të shkruara, pamore, materiale ose gojore shërbejnë si dëshmi për të kuptuar kontekste të ndryshme të jetës njerëzore në periudha të caktuara historike. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësi mëson të analizojë në thellësi burimet historike duke vlerësuar origjinën, qëllimin, audiencën dhe gjuhën e përdorur. Ai kupton se çdo burim bart një këndvështrim të caktuar dhe se vetëm nëpërmjet krahasimit të burimeve të ndryshme mund të ndërtohet një interpretim i argumentuar dhe kompleks i së kaluarës. Përdorimi i burimeve historike në këtë nivel kërkon që nxënësi të	Nxënësi ➢ përkufizon dhe analizon llojet kryesore të burimeve historike dhe shpjegon rolin e tyre në ndërtimin e njohurive mbi të kaluarën; ➢ vlerëson qëllimin, autorësinë, kontekstin dhe gjuhën e një burimi historik, duke identifikuar tone të anshme, qëndrime ideologjike apo përfaqësime të qëllimshme; ➢ krahason dhe kontraston burime me perspektiva të ndryshme për të analizuar të njëjtën ngjarje historike në mënyrë të balancuar; ➢ integron burime të ndryshme në ndërtimin e eseve apo projekteve kërkimore, duke cituar saktë dhe duke argumentuar në mënyrë të strukturuar dhe kritike; ➢ reflekton mbi kufizimet dhe mundësitë që ofrojnë burimet në interpretimin e historisë, duke qenë i vetëdijshëm për mungesat, shtrembërimet ose boshllëqet në dëshmi;

	dallojë besueshmërinë, përzgjedhjen selektive të informacionit, si dhe përdorimin e burimeve në funksion të ndërtimit të një narrative të mbështetur në prova. Nxënësi aftësohet të vlerësojë ndikimin që ka zgjedhja e burimeve në formësimin e njohjes historike dhe të kuptojë që historia është e ndërtuar dhe e interpretuar, jo vetëm e dhënë.	➢ përdor burime historike si mjet për të kuptuar më thellë ndikimin e përvojave historike në zhvillimet bashkëkohore dhe në ndërgjegjësimin qytetar.
Analiza shkak–pasojë	Analiza shkak–pasojë është një nga shtyllat kryesore të të kuptuarit historik në arsimin e mesëm të lartë. Ajo përfshin aftësinë për të identifikuar dhe interpretuar faktorët që ndikojnë në zhvillimin e ngjarjeve ose proceseve historike, si dhe për të kuptuar pasojat e tyre në nivele të ndryshme: politike, shoqërore, ekonomike, kulturore apo mjedisore. Kjo analizë shkon përtej renditjes kronologjike të fakteve dhe kërkon ndërlidhje të thella logjike ndërmjet shkaqeve të thella, shkaktarëve të drejtpërdrejtë dhe faktorëve të rastësishëm që kontribuojnë në rrjedhën e historisë.	Nxënësi: ➢ identifikon dhe analizon faktorë të shumtë që ndikojnë në fillimin, përshkallëzimin ose përfundimin e një ngjarjeje apo procesi historik, duke i klasifikuar ata si shkaqe të thella, të drejtpërdrejta apo të rastësishme; ➢ shpjegon pasojat politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të një ngjarjeje të rëndësishme historike në afat të shkurtër dhe të gjatë, në shkallë vendore dhe ndërkombëtare; ➢ ndërton argumente të mbështetura në prova për lidhjet shkak–pasojë, duke përdorur gjuhë të saktë historike dhe strukturë të qartë logjike në ese, analiza apo prezantime; ➢ reflekton mbi ndikimin e ndodhive të së kaluarës në zhvillimet bashkëkohore, duke evidentuar vazhdimësinë ose ndryshimin në kohë;

	Në këtë proces, nxënësi mëson të pranojë kompleksitetin e historisë duke kuptuar se një ngjarje mund të ketë origjinë në faktorë të shumtë dhe të prodhojë pasoja të ndryshme në varësi të kontekstit. Ai aftësohet të bëjë dallimin ndërmjet pasojave afatshkurtra dhe afatgjata, si dhe të lidhë ndodhitë historike me zhvillimet bashkëkohore. Kjo e ndihmon të kuptojë jo vetëm se "***çfarë ndodhi", por edhe "pse ndodhi" dhe "çfarë ndikimi ka pasur",*** duke ndërtuar një qasje analitike dhe kritike ndaj së kaluarës.	➢ vlerëson peshën relative të faktorëve në zhvillimin e një procesi historik dhe përdor mendim kritik për të krahasuar interpretime të ndryshme mbi shkaqet dhe pasojat e një ngjarjeje; ➢ përdor konceptet historike për të ndërtuar paralele mes së kaluarës dhe të tashmes dhe për të kuptuar më mirë sfidat e sotme përmes një perspektive historike.
Interpretimi historik	Interpretimi historik është aftësia për të kuptuar se historia nuk është një përmbledhje neutrale faktesh, por një proces i vazhdueshëm i ndërtimit të kuptimit mbi të kaluarën, bazuar në burime të ndryshme dhe këndvështrime të shumëllojshme. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësi mëson se mënyra se si ngjarjet, figurat dhe proceset historike interpretohen ndikohet nga konteksti	Nxënësi: ➢ analizon mënyra të ndryshme interpretimi të ngjarjeve apo figurave historike, duke krahasuar burime të prodhuara në periudha dhe vende të ndryshme; ➢ vlerëson ndikimin që kanë konteksti kulturor, politik dhe ideologjik në përzgjedhjen dhe përfaqësimin e përmbajtjes historike në tekste, muze, media apo arte;

	kulturor, politik, social dhe ideologjik i kohës në të cilën është prodhuar rrëfimi historik. Ai kupton se historianët dhe aktorë të tjerë publikë si artistë, politikanë, edukatorë apo media përzgjedhin, theksojnë dhe paraqesin pjesë të së kaluarës sipas qëllimeve të caktuara. Nxënësi aftësohet të analizojë përse një interpretim i caktuar është ndërtuar në një mënyrë të caktuar dhe të pyesë veten: *Kush e rrëfen historinë? Me çfarë qëllimi? Nga cilat burime? Çfarë lë jashtë?* Kjo kompetencë ndihmon në zhvillimin e një qëndrimi kritik dhe të vetëdijshëm ndaj narrativave historike dhe të mendimit të pavarur, duke nxitur respekt për pluralizmin dhe kuptimin e historisë si një fushë në evoluim të vazhdueshëm.	➢ shpjegon se si dhe pse ndryshojnë interpretimet historike në kohë dhe përse disa rrëfime janë më të përhapura ose më të diskutueshme se të tjerat; ➢ diskuton në mënyrë të argumentuar mbi paraqitjen pozitive, kritike apo të anshme të ngjarjeve historike në burime të ndryshme (p.sh., histori kombëtare vs. histori ndërkombëtare, media zyrtare vs. kujtime personale); ➢ ndërton interpretimin e vet mbi tema historike të caktuara, duke u mbështetur në analiza burimore dhe në ndërgjegjësimin se çdo rrëfim për të kaluarën është rezultat i përzgjedhjes dhe këndvështrimit të autorit; ➢ reflekton mbi ndikimin e edukimit, mediave dhe kulturës në formimin e qëndrimeve kolektive ndaj së kaluarës dhe zhvillon ndjeshmëri për qasjet shumë perspektive në histori.
Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën	Kjo kompetencë përfshin aftësinë e nxënësit për të kuptuar, shpjeguar dhe komunikuar të kaluarën historike në mënyrë të saktë, të organizuar dhe të argumentuar, duke përdorur gjuhë të qartë dhe mjete të ndryshme të komunikimit të shkruara,	Nxënësi: ➢ përshkruan dhe shpjegon ngjarje, procese dhe figura historike duke përdorur terminologji të saktë, strukturë të logjikshme dhe fakte të mbështetura në burime;

	gojore, vizuale apo digjitale. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësi përvetëson mënyra të avancuara të strukturimit të informacionit historik dhe mëson të ndërtojë rrëfime historike të bazuara në burime dhe interpretime kritike. Kjo kompetencë përfshin gjithashtu përdorimin e teknologjisë dhe inteligjencës artificiale (IA) si mjete të vlefshme në kërkimin, përpunimin dhe paraqitjen e përmbajtjes historike. Nxënësi aftësohet të vlerësojë cilësinë e informacionit të marrë nga teknologjia, të dallojë përmbajtjen e verifikuar nga ajo e pabazuar, dhe të tregojë qëndrime etike në përdorimin e mjeteve digjitale, duke respektuar privatësinë, autorësinë dhe integritetin e informacionit historik.	➢ organizon informacionin historik në mënyrë të qartë dhe koherente përmes eseve, prezantimeve gojore, grafikëve, hartave kronologjike, ose formave të tjera vizuale; ➢ përdor në mënyrë të vetëdijshme platforma digjitale, aplikacione kërkimore dhe mjete të avancuara për të gjetur, përzgjedhur dhe sintetizuar të dhëna historike; ➢ aplikon mjete të inteligjencës artificiale për të mbledhur, analizuar dhe strukturuar informacionin, duke ruajtur mendimin kritik dhe kontrollin mbi përmbajtjen e përftuar; ➢ vlerëson saktësinë, besueshmërinë dhe origjinën e informacionit të marrë nga burime digjitale, duke shmangur plagjiaturën dhe duke respektuar autorësinë; ➢ ndërton dhe prezanton materiale përmbajtjesore (postera digjitalë, projekte, podcast-e historike, ese me elementë multimedialë) mbi tema të zgjedhura, duke kombinuar burime tradicionale dhe teknologji moderne; ➢ shfaq qëndrime të përgjegjshme dhe etike në procesin e përgatitjes, përpunimit dhe shpërndarjes së përmbajtjes historike në mjedise digjitale dhe bashkëkohore.

Tabela 3: Konceptet kyçe historike dhe rezultatet e të nxënit

Kompetencat historike që zhvillohen përmes tematikave	Përshkrimi i kompetencave	Rezultatet e të nxënit për kompetencat për klasën e dhjetë
Kronologjia	Kronologjia është një nga konceptet themelore të të kuptuarit historik, që përfshin aftësinë për të kuptuar rendin dhe vijimësinë kohore të ngjarjeve historike dhe për t'i vendosur ato në kontekstin e periudhës përkatëse. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësi përvetëson një kuptim të thelluar të strukturës kohore të historisë, duke përdorur me saktësi datat, shekujt, emërtimet e epokave dhe fjalorin specifik historik për të renditur, krahasuar dhe analizuar periudha të ndryshme. Kuptimi kronologjik ndihmon në ndërtimin e një kornize të qartë analitike që mbështet kompetenca të tjera historike si analiza shkak–pasojë, interpretimi historik dhe krahasimi i periudhave. Ajo i ndihmon nxënësit të kuptojnë ndryshimin dhe vazhdimësinë në histori, si dhe të bëjnë lidhje ndërmjet së kaluarës dhe të tashmes në mënyrë të arsyetuar.	Nxënësi: ➢ përdor me saktësi datat, shekujt dhe termat historikë për të pozicionuar ngjarjet, proceset dhe figurat historike brenda një periudhe të caktuar kohore; ➢ analizon vijimësinë dhe ndryshimin historik në epoka të ndryshme (p.sh. nga Mesjeta në epokën moderne), duke përdorur korniza kohore të sakta; ➢ rendit dhe organizon informacionin historik në forma të avancuara si linja kohore tematike, tabela krahasuese dhe analiza të ndërlidhura ndër periudhore; ➢ kryen llogaritje të sakta kohore (p.sh. kalimi nga një shekull në tjetrin, përcaktimi i kohëzgjatjes së një periudhe apo krahasimi ndërmjet epokave); ➢ vlerëson rëndësinë e rendit kronologjik në analizën historike dhe e përdor atë për të ndërtuar narrativa dhe argumente të strukturuara;

		➢ lidh ngjarje të ndodhura në vende të ndryshme brenda të njëjtës periudhë kohore, për të kuptuar zhvillimet paralele dhe ndikimet ndërkombëtare;
Ndryshimi dhe vazhdimësia	Kuptimi i ndryshimit dhe vazhdimësisë është një nga shtyllat qendrore të të menduarit historik dhe ndihmon nxënësin të kuptojë se historia është një proces i ndërlikuar, në të cilin ndryshimet dhe elementët e qëndrueshëm ndërthuren në mënyra të ndryshme në kohë dhe hapësirë. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësi mëson të analizojë jo vetëm çfarë ka ndryshuar dhe çfarë ka mbetur e njëjtë, por edhe ritmin, shkallën dhe ndikimin e këtyre ndryshimeve, si dhe për kë ishin të rëndësishme ato. Ai zhvillon aftësinë për të krahasuar periudha dhe kontekste të ndryshme historike (p.sh. kalimi nga Mesjeta në epokën moderne, apo nga kolonializmi në shtet formimin kombëtar), për të vlerësuar se cilat institucione, ide apo struktura shoqërore kanë mbijetuar në kohë dhe për të reflektuar mbi përvojat e ndryshme të grupeve shoqërore përballë ndryshimit historik. Ky koncept i ndihmon nxënësit të kuptojnë se ndryshimi nuk është gjithmonë progres, dhe	Nxënësi ➢ identifikon dhe analizon ndryshime të rëndësishme në zhvillimin politik, ekonomik, kulturor apo social gjatë periudhave të caktuara historike dhe dallon elementët që kanë mbetur të qëndrueshëm; ➢ krahason struktura dhe përvoja historike në dy ose më shumë periudha kohore, duke theksuar progresin, regresin, apo vazhdimësinë e disa ideve, institucioneve apo praktikave (p.sh. organizimi shtetëror, roli i religjionit, modeli ekonomik); ➢ analizon ndikimin e ndryshimeve historike për grupe të ndryshme shoqërore, si elitat, gratë, pakicat etnike, punëtorët apo të rinjtë, dhe reflekton për perspektivat e tyre të ndryshme; ➢ përdor konceptet “ndryshim”, “vazhdimësi”, “ritëm”, “shkallë” dhe “ndikim” për të ndërtuar analiza historike të argumentuara dhe të mirë strukturuara; ➢ diskuton se si disa ndryshime historike janë përjetuar si progres nga disa grupe dhe si regres nga të tjerë, duke zhvilluar një qasje shumë perspektivike;

	se ndikimi i tij nuk është i njëjtë për të gjithë aktorët historikë.	➢ ndërton materiale (ese, tabela krahasimi, linja kohore tematike) që paraqesin evoluimin e një ideje apo institucioni në kohë dhe vendos ngjarjet në një rrjedhë të qartë dhe të argumentuar historike.
Diversiteti	Kuptimi i **diversitetit** në histori nënkupton aftësinë për të njohur dhe analizuar larminë e përvojave njerëzore në kohë dhe hapësirë. Në arsimin e mesëm të lartë, ky koncept zhvillon te nxënësi vetëdijen se historia nuk përbëhet nga një zë i vetëm, por nga një mozaik perspektivash të ndryshme kulturore, etnike, fetare, gjinore, shoqërore dhe ekonomike që formësojnë përvojat, përfaqësimin dhe kujtesën historike të individëve dhe grupeve. Në histori, diversiteti shfaqet në mënyrën si njerëzit kanë bashkëjetuar, bashkëpunuar, shkëmbyer apo hyrë në konflikt me njëri-tjetrin, përfshirë: - Diversitetin kulturor, që përfshin gjuhët, zakonet, traditat, besimet, artet dhe mënyrat e të jetuarit të komuniteteve të ndryshme në kohëra të ndryshme; - Diversitetin etnik dhe kombëtar, që lidhet me përkatësitë popullore dhe kombëtare, origjinat historike dhe marrëdhëniet ndërmjet shumicës dhe pakicave kombëtare, si pjesë përbërëse e historisë së një vendi;	Nxënësi: ➢ kupton se njerëzit dhe komunitetet në të njëjtën periudhë kohore kanë përjetuar historinë ndryshe, në varësi të përkatësisë së tyre kulturore, etnike, gjinore, fetare apo sociale; ➢ dallon mënyrat e bashkëjetesës, shkëmbimeve dhe konflikteve ndërmjet shumicës dhe pakicave kombëtare në periudha të ndryshme historike; ➢ respekton larminë kulturore dhe historike të shoqërisë shqiptare dhe asaj ndërkombëtare, duke vlerësuar rolin e pakicave kombëtare në trashëgiminë e përbashkët historike; ➢ analizon përvojat historike të grupeve të margjinalizuara, përfshirë gratë, pakicat, skllevërit, të rinjtë dhe komunitetet pa pushtet politik; ➢ kupton se konceptet e identitetit kombëtar dhe kulturor janë ndërtuar edhe përmes marrëdhënieve ndërmjet shumicës dhe pakicave, si dhe ndikimeve reciproke ndërkulturore;

	- Diversitetin fetar, që përfshin bashkëjetesën ose konfliktet ndërmjet besimeve dhe praktikave të ndryshme fetare në periudha të ndryshme historike; - Diversitetin social dhe ekonomik, që pasqyron ndryshimet në klasë shoqërore, profesion, mënyra jetese, të drejta dhe akses në burime e pushtet; - Diversitetin e mendimit dhe përfaqësimit, që lidhet me pikëpamje të ndryshme për të njëjtat ngjarje historike, në varësi të pozitës, përkatësisë ose përvojës së individëve dhe grupeve; - Diversitetin gjinor, që nënkupton rolet, përvojat dhe kontributet e ndryshme të gjinive në histori, veçanërisht të grave dhe vajzave, të cilat shpesh janë lënë jashtë rrëfimeve tradicionale. Në këtë kontekst, nxënësi mëson të zhvillojë ndjeshmëri ndërkulturore, mendim kritik ndaj narrativave përjashtuese dhe qëndrime qytetare të orientuara nga respekti dhe gjithëpërfshirja.	➢ ndërton qëndrime demokratike dhe gjithëpërfshirëse, duke kuptuar se historia është një bashkëjetesë përvojash që duhet të respektohen dhe njihen në mënyrë të barabartë.
Empatia historike	Empatia historike është aftësia për të kuptuar mendimet, ndjenjat, motivimet dhe veprimet e njerëzve që kanë jetuar në kohë dhe rrethana të ndryshme nga ato të sotmet. Ky	Nxënësi:

	koncept nuk ka të bëjë me të ndjerit keq apo me mëshirën ndaj figurave historike, por me përpjekjen për t'u vendosur në vendin e tyre, për të kuptuar botëkuptimin e tyre, mënyrën si ata e kanë perceptuar realitetin dhe si kanë marrë vendime në kontekstin e kohës ku kanë jetuar. Për të zhvilluar këtë aftësi, nxënësi mëson të shikojë dokumente dhe burime historike me kujdes dhe të mendojë: Si kanë jetuar këta njerëz? Çfarë e ka ndikuar mendimin dhe sjelljen e tyre? A kanë pasur zgjedhje të lehta apo të vështira? Empatia historike ndihmon nxënësit të kuptojnë se jeta në të kaluarën ishte ndryshe nga jeta e sotme dhe se njerëzit bënin zgjedhje sipas kohës së tyre, jo sipas mënyrës si ne mendojmë sot. Ajo i ndihmon gjithashtu të jenë më të kuptueshëm dhe më të respektueshëm ndaj ndryshimeve kulturore dhe historike. Empatia historike është një urë lidhëse midis të shkuarës dhe të tashmes. Ajo i ndihmon nxënësit të zhvillojnë mendim kritik, ndjeshmëri kulturore dhe të ndërtojnë qëndrime më të reflektuara dhe të përgjegjshme si qytetarë të një bote shumëdimensionale dhe ndërkulturore.	✓ analizon mënyrën si faktorët historikë, si konteksti kulturor, politik, ekonomik dhe social, kanë ndikuar në zgjedhjet, bindjet dhe veprimet e individëve apo grupeve historike; ✓ argumenton se nuk është e drejtë të gjykosh të kaluarën me vlerat e së tashmes dhe se kuptimi i rrethanave historike është thelbësor për të ndërtuar interpretime të balancuara; ✓ interpreton burime historike për të rindërtuar pikëpamjet dhe ndjenjat e njerëzve në kohë të ndryshme, duke nxjerrë në pah kompleksitetin e përvojave historike; ✓ paraqet këndvështrime të ndryshme historike, duke përfshirë zëra të shpesh të lënë në harresë (si gra, pakica, të rinj etj.); ✓ reflekton mbi dilemat morale dhe njerëzore të figurave apo shoqërive historike, duke shfaqur ndjeshmëri, mirëkuptim dhe respekt për diversitetin e përvojës njerëzore; ✓ zhvillon qëndrime të përgjegjshme qytetare dhe ndërkulturore, duke kuptuar rolin e empatisë historike për të ndërtuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse, të vetëdijshme dhe kritike ndaj narrativave të njëanshme historike. ✓ refuzon stereotipet, gjykimet e thjeshtuara dhe paragjykimet në analizën e ngjarjeve, grupeve apo individëve të së kaluarës,

		duke argumentuar rëndësinë e vlerësimit të tyre në kontekstin historik të kohës dhe vendit.
Rëndësia historike	Rëndësia historike lidhet me vlerësimin kritik të ndikimit që kanë pasur ngjarjet, individët, idetë apo proceset historike në kohën kur kanë ndodhur dhe në ndikimin e tyre të mëvonshëm, përfshirë lidhjet me të tashmen. Ky koncept kërkon që nxënësi të analizojë jo vetëm se çfarë ka ndodhur, por përse ajo që ka ndodhur është konsideruar e rëndësishme, për kë ka qenë e rëndësishme dhe si është ruajtur, interpretuar apo transformuar rëndësia e saj në periudha të ndryshme kohore dhe kontekste të ndryshme shoqërore. Kuptimi i rëndësisë historike zhvillon të menduarin historik duke e nxitur nxënësin të mendojë për kriteret e përzgjedhjes, përfshirë ndikimin afatgjatë, shkallën e përfshirjes së shoqërisë, transformimet strukturore që sjell një ngjarje apo figurë, si dhe trashëgiminë që ajo lë. Kjo ndihmon në formimin e gjykimit historik dhe në reflektimin mbi mënyrën se si ndërtohet dhe rivlerësohet memoria historike.	Nxënësit: ➢ analizon se jo çdo ngjarje apo figurë historike ka të njëjtën peshë në memorien kolektive, duke vlerësuar shkallën e ndikimit dhe qëndrueshmërinë e saj në kohë; ➢ vlerëson rëndësinë e një zhvillimi historik në raport me kontekstin e kohës dhe me pasojat që ai ka prodhuar për individët, komunitetet apo institucionet; ➢ përdor kritere të qarta për të gjykuar rëndësinë e ngjarjeve, si ndikimi afatgjatë, ndryshimi i rendit ekzistues, përfshirja masive e popullsisë apo ndërlidhja me zhvillimet aktuale; ➢ krahason rëndësinë e dy apo më shumë fenomeneve historike, duke justifikuar gjykimin përmes argumenteve dhe burimeve të verifikueshme; ➢ diskuton se si figura të caktuara historike janë përfaqësuar në periudha të ndryshme dhe pse rëndësia e tyre është rishikuar apo kontestuar; ➢ kupton se rëndësia historike nuk është absolute, por është rezultat i një procesi përzgjedhjeje, interpretimi dhe ndërtimi të kujtesës në shërbim të shoqërisë.

4 PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Programi i historisë në arsimin e mesëm të lartë formon te nxënësi një kuptim të thelluar dhe kritik të realitetit bashkëkohor, duke i mundësuar atij të analizojë ngjarjet aktuale në dritën e proceseve dhe përvojave historike, si dhe të ndërtojë perspektiva të informuara për të ardhmen.

Diagrama 1. Korniza konceptuale e lëndës së historisë

- 🕮 Historia e shqiptarëve
- 🕮 Historia e qytetërimeve botërore



4.1 Koha mësimore për secilën tematikë për klasën e dhjetë

Lënda e Historisë në klasën e dhjetë zhvillohet gjatë 36 javëve të vitit shkollor, me një ngarkesë prej 2 orësh në javë, duke përbërë gjithsej 72 orë mësimore në vit. Programi i historisë sugjeron peshën (orët e sugjeruara) për secilën tematikë. Shpërndarja e orëve ka për qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në raport me orët totale vjetore.

Tabela 4. Shpërndarja e orëve mësimore, klasa X

KLASA X	
Tematika	**Orë të sugjeruara**
1 Qytetërimi antik Grek dhe Romak	8
2 Qytetërimet botërore në mesjetë (Shek. V – Shek. XV)	11
3 Qytetërimet në fillimet e historisë moderne	7
4 Koha e ndryshimeve thelbësore.	16
5 Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945)	13
6 Qytetërimet bashkëkohore (1945 – sot)	17
Totali	**72**

4.2 Përmbajtja e klasës së dhjetë

Në klasën e dhjetë, programi i lëndës "Histori" trajton modele të qytetërimeve botërore në periudhat antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore. Nëpërmjet këtyre modeleve, programi synon të shpjegojë etapat kryesore të zhvillimit të shoqërisë botërore, duke analizuar mënyrat e jetesës, trashëgiminë materiale dhe shpirtërore, si edhe organizimin ekonomik, politik dhe kulturor të qytetërimeve, me qëllim kuptimin e lidhjeve ndërmjet tyre dhe vazhdimësisë në kohë. Nxënësit udhëzohen të dallojnë kalimin nga qytetërimet e lashta në ato mesjetare, moderne dhe bashkëkohore, duke kuptuar ndikimet reciproke dhe vijimësinë historike të proceseve globale.

Në përmbajtjen e programit të historisë, një vend të veçantë zë zhvillimi i veprimtarive praktike, të cilat përbëjnë një pjesë thelbësore të procesit të të nxënit. Këto veprimtari janë paraqitur për secilën njësi tematike të klasës së dhjetë, në rubrikën "Veprimtari të sugjeruara për tematikën". Ato synojnë të nxisin zhvillimin e aftësive të mendimit kritik, mendimit krijues dhe zgjidhjes së problemeve, përmes përfshirjes aktive të nxënësve në ndërtimin e njohurive historike, duke u bazuar në përvoja të drejtpërdrejta mësimore. Për çdo veprimtari praktike të parashikuar në programin e historisë për klasën X -të , janë përcaktuar rezultate të të nxënit që theksojnë:

- integrimin e historisë së Shqipërisë me historinë e qytetërimeve evropiane dhe më gjerë, duke ndërtuar ura lidhëse ndërmjet zhvillimeve lokale dhe atyre globale;
- forcimin e identitetit kombëtar, ndjenjës së patriotizmit, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, si dhe kuptimin e ndikimeve ndërkulturore;
- njohjen dhe trajtimin e historisë së pakicave kombëtare, si pjesë përbërëse e mozaikut historik dhe shoqëror;
- analizën e rreziqeve natyrore, pandemive, krizave ekonomike dhe politike, me fokus në rolin e historisë në kuptimin dhe përballimin e sfidave bashkëkohore;
- vlerësimin e ndikimit të zhvillimeve teknologjike në transformimin e jetës shoqërore dhe të realitetit bashkëkohor, duke nxitur reflektimin mbi rolin e tyre në të tashmen dhe të ardhmen.

Njohuritë dhe aftësitë e parashikuara në program, të integruara me veprimtaritë praktike si dy komponentë të pandarë, synojnë të nxisin tek nxënësit ndërtimin e kompetencave lëndore dhe kompetencave kyçe për të nxënë gjatë gjithë jetës, duke e bërë procesin mësimor më gjithëpërfshirës dhe domethënës.

KLASA E DHJETË

4.2.1 Tematika: Qytetërimi antik Grek dhe Romak

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS	
Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi kushtet, etapat dhe tiparet ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore të qytetërimeve antike në Greqi dhe Romë. Kjo tematikë pajis nxënësin me njohuri, shprehi dhe qëndrime për të analizuar e krahasuar zhvillimet e qytetërimeve antike në Greqi dhe Romë duke evidentuar lidhjen midis këtyre qytetërimeve. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar edhe veprimtari praktike, të cilat jepen në rubrikën "Veprimtari të sugjeruara për tematikën". Këto orë veprimtarish mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës.	
KLASA 10 **NJOHURITË**	**KLASA 10** **REZULTATET E TË NXËNIT** **(*Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës*)**
- **Qytetërimi antik Grek** - **Qytetërimi antik Romak** - **Besimi në Greqinë dhe Romën antike** - **Rënia e qytetërimeve antike në Evropë**	**Qytetërimi antik Grek** *Nxënësi:* - shpjegon kuptimin e konceptit qytetërim; - shpjegon kuptimin e konceptit antikitet; - vlerëson rolin e mjedisit në zhvillimin e qytetërimeve antike; - përcaktohen kohën dhe rrethanat e lindjes së qytetërimit antik grek; - përcakton në hartë vendndodhjen e qytetërimit antik grek; - shpjegon dhe krahason organizimin politik të qytet – shteteve në Greqinë antike; - shpjegon dhe krahason tiparet e qeverisjes në Greqinë antike;

	- përcakton në hartë shtrirjen e kolonive greke; - shpjegon tiparet e organizimit shoqëror në Greqinë antike; - dallon elemente të jetës së përditshme në qytetërimin antik grek; - përshkruan tiparet e artit, kulturës, shkencës dhe arsimit në qytetërimin antik grek; **Qytetërimi antik Romak** *Nxënësi:* - përcaktohen kohën dhe rrethanat e lindjes së qytetërimit antik romak; - përcakton në hartë vendndodhjen e qytetërimit antik romak; - shpjegon dhe krahason format e organizimit shtetëror në Romën antike; - vlerëson rëndësinë e së "drejtës romake"; - përcakton në hartë shtrirjen e Perandorisë Romake; - evidenton rrugët nëpërmjet të cilave u përhap ky qytetërim; - shpjegon tiparet e organizimit shoqëror në Romën antike; - dallon elemente të jetës së përditshme në qytetërimin antik romak; - përshkruan tiparet e artit, kulturës, shkencës dhe arsimit në qytetërimin antik romak; **Besimi në antikitet** *Nxënësi:* - përcakton veçoritë e besimit në Greqinë dhe Romën antike;

	- shpjegon kushtet e lindjes së krishterimit, duke evidentuar rrethanat historike të kalimit nga besimi pagan në atë të krishterë; - shpjegon faktorët historikë që ndikuan në përhapjen e krishterimit. **Rënia e qytetërimeve antike në Evropë** *Nxënësi:* - përcakton faktorët historikë që shkaktuan rënien e Perandorisë romake; - shpjegon pasojat që solli dyndja e popujve në Evropë; - vlerëson rolin e lëvizjeve së popujve në lindjen e qytetërimit mesjetar;

KONCEPTE DHE TERMA

Qytetërim, polis, oligarki, demokraci, republikë, perandori, patricë, plebenj, skllavopronarë, koloni greke, hark triumfi, koloseu, akropol, obelisk, edukim spartan, e folur lakonike, paganizmi; krishterim, krizë, dyndje e popujve, dyndjet sllave, kultura helenistike.

VEPRIMTARI TË SUGJERUARA PËR TEMATIKËN "QYTETËRIMI ANTIK GREK DHE ROMAK"

Qytetërimet antike në brigjet e lumenjve

- Diskuton për zhvillimin e qytetërimeve antike në brigjet e lumenjve.
- Vlerëson rëndësinë e mjedisit natyror në formësimin e mënyrës së jetesës, organizimit politik dhe kulturës së këtyre qytetërimeve.

Periudha Helenistike

- Përcakton në hartë fushatat e Aleksandërit të Madh dhe hapësirat gjeografike ku u përhap ndikimi helenistik.
- Evidenton karakteristikat e kulturës helenistike dhe përzierjen e elementeve greke me ato të qytetërimeve lindore.
- Vlerëson rolin e Aleksandërit të Madh në krijimin dhe përhapjen e kulturës helenistike dhe në bashkimin e elementeve kulturore nga Lindja dhe Perëndimi, duke kontribuar në ndërtimin e një bote të hapur dhe ndërkulturore.

Trashëgimia kulturore nga qytetërimet antike, ndikimi në jetën shqiptare dhe sfidat e ruajtjes

- Eksploron monumente, rrënoja ose qytete antike në Shqipëri që mbartin ndikime greke dhe romake (p.sh. Apolonia, Amantia, Durrësi, Butrinti).
- Analizon rëndësinë e trashëgimisë historike për ndërtimin e identitetit kombëtar.
- Reflekton për problemet që hasen sot në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, si mungesa e dijes, dëmtimet nga ndërtimet moderne, pakujdesia, ndikimi negativ i turizmit të pakontrolluar, mungesa e fondeve etj.
- Diskuton lidhjen midis trashëgimisë historike dhe sfidave bashkëkohore, duke kuptuar nevojën për mbrojtje dhe mirë menaxhim të saj.
- Shpreh ide konkrete për mbrojtjen e saj, duke e parë historinë jo si të shkuar të largët, por si pasuri që duhet ruajtur dhe promovuar.
- Përdor teknologjinë për të paraqitur këto ide (p.sh. poster digjital, prezantim me video), në mbrojtjen e trashëgimisë dhe për të ndërgjegjësuar brezim e ri rreth vlerës së trashëgimisë.
- Zhvillon mendim kritik dhe ndjeshmëri qytetare për çështje që lidhen me identitetin kombëtar, trashëgiminë kulturore dhe vlerat ndërkulturore.

4.2.2 Tematika: Qytetërimet botërore në mesjetë

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS	
Përmes kësaj tematike nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi etapat kryesore nëpër të cilat ka kaluar zhvillimi i shoqërisë mesjetare dhe qytetërimet në mesjetë. Nxënësi shpjegon kalimin nga qytetërimet antike në qytetërimet mesjetare, kupton lidhjen ndërmjet tyre, tregon ndryshimet që pësuan këto qytetërime në mesjetë, analizon veçoritë e organizmit ekonomik, politik dhe kulturor të këtyre qytetërimeve. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar edhe veprimtari praktike cilat jepen në rubrikën "Veprimtari të sugjeruara për tematikën". Këto orë veprimtarish mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës.	
KLASA 10	**KLASA 10**

NJOHURITË	REZULTATET E TË NXËNIT (*Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës*)
- **Qytetërimi bizantin** - **Tiparet e qytetërimit arab** - **Perandoria e shenjtë Romake** - **Monarkia Angleze** - **Monarkia Franceze** - **Marrëdhëniet midis qytetërimit arab dhe qytetërimeve evropiane** - **Perandoria Osmane**	**Qytetërimi bizantin** *Nxënësi:* - shpjegon shkaqet e lindjes së qytetërimit bizantin; - përcakton në hartë procesin e shtrirjes së perandorisë bizantine; - analizon tiparet e organizimit shtetëror të Perandorisë Bizantine; - vlerëson rolin e kodit të Justinianit në qytetërimin Bizantin duke argumentuar vlerat e tij sot; - shpjegon tiparet e jetës së përditshme, organizimit ekonomik dhe shoqëror të Perandorisë Bizantine; - shpjegon tiparet e artit, kulturës, shkencës dhe arsimit në qytetërimin bizantin; - përshkruan tiparet e besimit në qytetërimin bizantin dhe evidenton shkakun e ndarjes së kishës së krishterë. **Tiparet e qytetërimit arab** *Nxënësi:* - shpjegon kushtet historike të lindjes së islamit dhe përhapjes së tij; - demonstron në hartë fazat e shtrirjes së Kalifatit Arab; - shpjegon tiparet e organizimit shtetëror në Kalifatit Arab; - shpjegon tiparet e jetës së përditshme, organizimit ekonomik dhe shoqëror në qytetërimin arab;

	- shpjegon tiparet e shkencës, artit, kulturës, arsimit dhe besimit në qytetërimin arab; - evidenton ndikimin e qytetërimit arab në Evropë dhe Botë; - argumenton rëndësinë e qytetërimit arab. **Perandoria e shenjtë Romake** *Nxënësi:* - shpjegon kushtet historike të lindjes së Perandorisë së shenjtë Romake; - përcakton në hartë shtrirjen e Perandorisë së shenjtë Romake; - evidenton tiparet e jetës së përditshme të frankëve; - shpjegon lindjen e dy autoriteteve në Evropë: Perandori dhe Papa. - argumenton forcimin e autoritetit papal në Evropë; **Monarkia Angleze** *Nxënësi:* - tregon prej nga dhe kur erdhën në ishullin britanik anglo-sanksonët; - shpjegon procesin e krijimit të monarkisë së parë angleze; - identifikon monarkitë e centralizuar në hartën politike të Evropës mesjetare; - shpjegon marrëdhëniet midis lordëve dhe këtyre me mbretin në Angli; - përshkruan përmbajtjen e Kartës së Madhe të Lirive dhe vlerëson karakterin e saj; - vlerëson rolin e parlamentit në monarkinë angleze; **Monarkia Franceze**

	Nxënësi: - analizon tiparet e feudalizmit në Francë; - shpjegon marrëdhëniet hierarkike midis feudalëve dhe mbretërve në Francë, duke analizuar shkaqet e këtyre marrëdhënieve; - shpjegon arsyet e krijimit të asamblesë kushtetuese; - vlerëson rolin e asamblesë kushtetuese në jetën politike në Francë; - shpjegon arsyet e forcimit të pushtetit të mbretit në Francë duke analizuar tiparet e monarkisë në Francë; - krahason tiparet e parlamentin anglez me atë të asamblesë së përgjithshme në Francë. **Marrëdhëniet midis qytetërimit arab dhe qytetërimeve evropiane** *Nxënësi:* - shpjegon konceptin kryqëzatë; - shpjegon shkaqet e fillimit të kryqëzatave; - përcakton në hartë itinerarin e lëvizjes së kryqtarëve drejt lindjes; - analizon karakterin dhe grupet pjesëmarrëse në kryqëzata si dhe qëllimet e tyre; - evidenton pasojat e kryqëzatave dhe marrëdhënien ndërmjet dy qytetërimeve; Perandoria Osmane *Nxënësi:* - përshkruan rrugën e krijimit të shtetit osman; - shpjegon kushtet historike të formimit të Perandorisë Osmane;

	- përcakton në hartë shtrirjen e Perandorisë Osmane sipas periudhave të zgjerimit të saj; - analizon tiparet e jetës ekonomike, politike dhe shoqërore në Perandorinë Osmane.

KONCEPTE DHE TERMA

Mesjetë, ndarja e kishës, perandori, katolicizëm, ortodoksi, kod, islam, kalifat, kalif, kuran, vend i shenjtë, feudalizëm, fisnikëri, vasalitet, bujkrobëri, detyrim, qytet, romanizim, anglo-sakson, çiflig, komunë, Karta e Madhe e Lirive, monarki e kufizuar, republikë, emancipim, kryqëzatë, ripushtim, sistem feudal-ushtarak, sulltan, spahi, timar, prona, perandori shumëkombëshe, krahina të vetëqeverisura, jeniçer.

VEPRIMTARI TË SUGJERUARA PËR TEMATIKËN "QYTETËRIMET BOTËRORE NË MESJETË"

Jeta e përditshme dhe kultura në Evropën mesjetare

- Përshkruan zhvillimin e qyteteve dhe të tregtisë në Evropën mesjetare.
- Krahason mënyrën e jetesës së shtresave të ndryshme shoqërore në Evropën mesjetare.
- Evidenton tiparet e zhvillimit të artit, të kulturës dhe të arsimit në qytetërimet mesjetare.
- Gjykon për rolin e fesë në qytetërimet mesjetare.
- Krahason prirjet e zhvillimit të artit, të kulturës dhe të arsimit ndërmjet qytetërimit arab dhe qytetërimeve evropiane.

Nga Mesjeta në të ardhmen, sfidat dhe mësimet

***Qëllimi**:* Të kuptojë mënyrat se si qytetërimet mesjetare janë përballur me sfida të mëdha si pandemitë, uria, krizat politike dhe teknologjitë e kohës, duke i lidhur me realitetin bashkëkohor.

- Studion raste konkrete si Murtaja e Zezë, krizat e urisë në Evropë, zhvillimin e teknikave të reja bujqësore dhe teknologjitë e informacionit mesjetare (si shtypshkronja, rrjeti i rrugëve etj.).
- Reflekton mbi aftësinë e shoqërive historike për t'u përshtatur dhe për të përballuar kriza të shumta.

- Krahason krizat mesjetare me krizat bashkëkohore si pandemia COVID-19, krizat klimatike dhe migracioni masiv, duke vlerësuar ngjashmëritë dhe ndryshimet mes tyre.
- Diskuton mbi mësimet që mund të nxjerrim nga historia për menaxhimin e sfidave aktuale dhe analizon mënyrat se si historia mund të na ndihmojë në përballimin e krizave ekonomike, emergjencave mjedisore apo shëndetësore.
- Vlerëson ndikimin e zhvillimeve teknologjike në transformimin e jetës shoqërore, si në të kaluarën ashtu edhe në të tashmen.
- Harton një broshurë me titull: "Çfarë na mëson Mesjeta për të Ardhmen?", e cila përfshin reflektime historike dhe propozime konkrete për zgjidhje të sfidave moderne përmes bashkëpunimit, inovacionit dhe përdorimit të teknologjisë.

Gjurmët e Mesjetës në Shqipëri

***Qëllimi**:* Të zhvillojë kompetencat historike, mendimin kritik dhe ndjeshmërinë qytetare për trashëgiminë kulturore dhe identitetin kombëtar, përmes integrimit të historisë së Shqipërisë në kontekstin e qytetërimeve mesjetare.

***Përshkrimi**:* Nxënësit ndahen në grupe dhe eksplorojnë gjurmët e qytetërimeve mesjetare në Shqipëri (si periudha e Bizantit, ndikimi i Perandorisë Osmane, principatat shqiptare). Secili grup:

- Zgjedh një objekt historik, personalitet apo ngjarje nga mesjeta shqiptare.
- Hulumton lidhjen e këtij elementi me qytetërimet më të mëdha të kohës dhe ndikimin në identitetin dhe trashëgiminë kulturore shqiptare.
- Krijon një poster me informacion historik, pyetje reflektuese dhe komente mbi rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë.
- Organizon një ekspozitë në klasë me prezantime të shkurtra për publikun (prindër, mësues të tjerë, nxënës).
- Analizon burime historike dhe përzgjedh informacion të vlefshëm për të ndërtuar njohuri mbi trashëgiminë mesjetare në Shqipëri.
- Krahason elementët e trashëgimisë shqiptare me zhvillimet në qytetërimet botërore në mesjetë.
- Vlerëson ndikimin e trashëgimisë historike në ndërtimin e identitetit kombëtar dhe në forcimin e ndjenjës së patriotizmit.
- Reflekton mbi rolin e komunitetit në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

- Përdor forma kreative dhe teknologjike për të paraqitur rezultatet e punës dhe për të ndërgjegjësuar komunitetin shkollor mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore.

4.2.3 Tematika: Qytetërimet në fillimet e historisë moderne

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS	
Përmes kësaj tematike nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi kthesën e madhe që morën qytetërimet botërore pas Rilindjes Evropiane dhe Zbulimeve të Mëdha Gjeografike. Përmes kësaj tematike, nxënësit shpjegojnë ndryshimet rrënjësore në jetën ekonomike, politike, shoqërore, humane, kulturore, shkencore dhe fetare të cilat sollën fillimin e botës moderne dhe patën ndikim në arritjet e qytetërimit bashkëkohor. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar edhe veprimtari praktike të cilat jepen në rubrikën "Veprimtari të sugjeruara për tematikën". Këto orë veprimtarish mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika sëbashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës.	
KLASA 10 **NJOHURITË**	**KLASA 10** **REZULTATET E TË NXËNIT** **(*Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës*)**
- Italia qendër e Rilindjes dhe kulturës Evropiane. **- Zbulimet e mëdha gjeografike** **- Ndryshimet fetare në Evropë** **- Perandoria Osmane dhe Ballkani**	**Italia si qendër e Rilindjes dhe kulturës Evropiane** *Nxënësi:* - argumentojë arsyet e shndërrimit të qyteteve italiane në djepin e qytetërimit modern evropian; - shpjegon ndikimin e humanistëve italian në qytetërimin evropian; - vlerëson rolin e qyteteve italiane në lindjen e humanizmit dhe rilindjes evropiane;

	- evidenton rolin e kishës dhe familjeve të mëdha italiane në organizimin e lëvizjes kulturore në Itali; - vlerëson rolin e lëvizjes kulturore italiane në qytetërimin Evropian; **Zbulimet e mëdha gjeografike** *Nxënësi:* - analizon rrethanat që shkaktuan "Zbulimet e mëdha gjeografike"; - përcakton në hartë rrugën që përshkuan udhëtarët evropianë, në kërkim të Amerikës, Afrikës dhe Australisë; - vlerëson kulturën e popujve vendas; - shpjegon pasojat e zbulimeve të mëdha gjeografike; **Ndryshimet fetare në Evropë** *Nxënësi:* - analizon shkaqet e ndryshimeve fetare në Gjermani; - analizon pasojat e reformës protestante në qytetërimin evropiane; - analizon shkaqet e ndryshimeve fetare në shtetin Papal; - analizon pasojat e reformës katolike në qytetërimin evropiane; **Perandoria Osmane dhe Ballkani** *Nxënësi:* - të përcaktojë në hartë zgjerimin e Perandorisë Osmane në Ballkan; - të analizojë tiparet e politikës osmane në Ballkan;

	- të vlerësojë trashëgiminë osmane në art, kulturë, shkencë, ekonomi, dhe në jetën e përditshme.

KONCEPTET DHE TERMAT

Iluminizëm, Humanizëm, Rilindje evropiane, familje të mëdha italiane, Zbulimet e mëdha gjeografike, reformë protestante, reformë katolike, idetë e Luterit, sistemi i miletit, trashëgimi osmane.

VEPRIMTARI TË SUGJERUARA PËR TEMATIKËN "QYTETËRIMET NË FILLIMET E HISTORISË MODERNE"

Jeta e përditshme në Evropë dhe në Shqipëri gjatë shek. XVI-XVII

- Përshkruan mënyrën e jetesës në mjediset urbane dhe rurale të Evropës dhe Shqipërisë, përfshirë organizimin familjar, zakonet, ushqimin, veshjen dhe kushtet e banimit.
- Dallon ndryshimet midis jetës së shtresave të larta dhe të ulëta shoqërore në aspektin e jetës së përditshme.
- Analizon ndikimin e kushteve ekonomike, strukturave feudale dhe marrëdhënieve me pushtetin osman në jetën e përditshme të shqiptarëve.
- Analizon zhvillimet në art, kulturë, shkencë dhe arsim në Evropë
- Identifikon ndikimin e Rilindjes Evropiane dhe Reformës protestante në jetën kulturore dhe mendimin evropian.
- Përshkruan figurat dhe veprat më përfaqësuese të artit dhe shkencës (si Leonardo da Vinci, Galileo Galilei, Shakespeare, Koperniku) dhe ndikimin e tyre afatgjatë.
- Analizon rolin e kishës, universiteteve dhe shtypit në përhapjen e dijes dhe arsimit gjatë kësaj periudhe.
- Diskuton zhvillimet arsimore dhe kulturore në Shqipëri nën Perandorinë Osmane
- Përshkruan ndikimin e administratës osmane në jetën kulturore dhe arsimore të shqiptarëve në këtë periudhë si veprimtarinë e shkollave fetare (medrese, mektebe, shkolla katolike) dhe rolin e tyre në formimin e elitës lokale.
- Dallon trashëgiminë kulturore dhe shoqërore të periudhës osmane në trevat shqiptare.

- Krahason jetën e përditshme në Shqipëri dhe në vende të ndryshme të Evropës
- Identifikon ngjashmëri dhe dallime në mënyrën e organizimit të jetës së përditshme midis Shqipërisë nën sundimin osman dhe vendeve evropiane si Italia, Franca apo Anglia.
- Analizon faktorët që ndikonin në përparimin kulturor dhe shkencor në Perëndim dhe pengesat që kufizonin këtë zhvillim në trevat shqiptare.
- Reflekton mbi rëndësinë e zhvillimeve të kësaj periudhe për botën moderne
- Shpjegon se si zbulimet shkencore dhe zhvillimet kulturore të kësaj periudhe ndikuan në formimin e mendimit modern dhe në transformimin e shoqërisë perëndimore.
- Kupton ndikimin afatgjatë të Rilindjes, Reformës dhe revolucionit shkencor në zhvillimet e mëvonshme politike, sociale dhe arsimore.
- Përdor burime historike për të përshkruar jetën e përditshme në këtë periudhë
- Analizon imazhe historike, tekste burimore, fragmente nga udhëtime apo dokumente arkivore për të rindërtuar një pamje të jetës së përditshme në shek. XVI–XVII.
- Realizon përmbledhje, postera ose projekte që pasqyrojnë dallimet kulturore mes vendeve të ndryshme të Evropës dhe Shqipërisë.

4.2.4 Tematika: Koha e ndryshimeve thelbësore

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS	
Përmes kësaj tematike nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi ndryshimet rrënjësore, që shkaktuan revolucionet politike, industriale dhe ideologjike në qytetërimin perëndimor dhe botëror. Linja përfshin lindjen e nacionalizmit i cili çoi në krijimin e shteteve nacionale ne Evropën Qendrore dhe Ballkan. Gjithashtu linja trajton edhe fillimet e liberalizmit në jetën politike dhe ekonomike që i siguroi qytetarit të drejtat sociale dhe politike. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar edhe veprimtari praktike të cilat jepen në rubrikën "Veprimtari të sugjeruara për tematikën". Këto orë veprimtarish mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës.	
KLASA 10 **NJOHURITË**	**KLASA 10** **REZULTATET E TË NXËNIT** **(*Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës*)**
- **Absolutizmi në Francë** - **Rusia nën drejtimin e monarkëve iluministë** - **Spanja dhe Portugalia: shtetet e para koloniale** - **Revolucioni Anglez** - **Revolucioni Amerikan** - **Revolucioni Francez** - **Revolucioni i Parë dhe i Dytë Industrial** - **Perandoria osmane, model i shpërbërjes së Perandorive shumëkombëshe**	**Absolutizmi në Francë** *Nxënësi:* - analizon tiparet e absolutizmit gjatë qeverisjes së Luigjit XIV; - shpjegon strukturën e organizimin të oborrit mbretëror; - krahason mënyrën e jetesës së shoqërisë sipas shtresave ndërmjet kryeqytetit dhe provincës; - vlerëson rolin e Luigjit XIV në arkitekturën e kryeqytetit të Francës; **Rusia nën drejtimin e monarkëve iluministë** *Nxënësi:* - përcakton konceptin monarkë iluministë;

- **Bashkimi i Italisë** - **Gjermania** - **Anglia drejt demokracisë liberale**	- shpjegon tiparet e qeverisjes së Pjetrit të Madh dhe të Katerinës II; - analizon ndikimin e iluminizmit në zhvillimin e Rusisë gjatë qeverisjes së Pjetrit të Madh dhe të Katerinës II; **Spanja dhe Portugalia: shtetet e para koloniale** *Nxënësi:* - përcakton në hartë shtrirjen e kolonive spanjolle dhe portugeze në Amerikën Qendrore dhe Jugore; - analizon tiparet e ekonomisë së kolonive spanjolle dhe portugeze; - shpjegon marrëdhëniet midis kolonizatorëve evropiane dhe vendasve; - evidenton pasojat e kolonizimit spanjoll dhe portugez. **Revolucioni Anglez** *Nxënësi:* - përkufizon konceptin revolucion politik; - përcakton dhe shpjegon fazat e revolucionit anglez, duke argumentuar evolucionin politik të tij; - analizon përmbajtjen, karakterin dhe vlerat e Aktit mbi të Drejtat e Njeriut; - shpjegon tiparet e qeverisjes pas revolucionit në Angli; **Revolucioni Amerikan** *Nxënësi:* - shpjegon shkaqet e luftës për pavarësi të kolonive angleze të Amerikës së Veriut;

	- vlerëson rëndësinë e Deklaratës së Pavarësisë të kolonive angleze të Amerikës së Veriut; - analizon kushtetutën amerikane dhe argumenton rëndësinë e saj në demokracinë amerikane; - analizon shkaqet e luftës civile, duke nxjerrë përfundime për rrjedhojat e saj; **Revolucioni Francez** *Nxënësi:* - analizon shkaqet e shpërthimit të Revolucionit në Francë; - përcakton dhe shpjegon fazat e Revolucionit francez; - argumenton vlerat e Deklaratës mbi të "Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit"; - analizon idetë e reja të revolucionit francez dhe ndikimin e tyre në qytetërimin botëror; - shpjegon faktorët e ardhjes në pushtet të Napoleon Bonaparte; - shpjegon fushat dhe karakterin e reformave të ndërmarra nga Napoleoni, duke analizuar ndikimin e tyre në qytetërimin francez dhe atë evropian; - përcakton në hartë fazat e zgjerimit të territorit francez në periudhën e Napoleonit; - evidenton ndryshimet politike që pësoi Evropa pas rënies së Napoleonit dhe Kongresit të Vjenës. **Revolucioni i Parë dhe i Dytë Industrial** *Nxënësi:* - përkufizon konceptin Revolucion Industrial; - shpjegon arsyet përse Anglia u bë atdheu i Revolucionit të Parë Industrial;

	- evidenton arritjet e këtij revolucioni në industrinë tekstile, metalurgji dhe transport; - shpjegon ndryshimet sociale që solli ky Revolucion; - argumenton ndikimin e Revolucionit të Dytë industrial me zhvillimin e industrisë dhe urbanizimit; - vlerëson ndikimet që ato patën në jetën ekonomike e sociale të qytetërimeve botërore. **Perandoria osmane, model i shpërbërjes së Perandorive shumëkombëshe** *Nxënësi:* - shpjegon faktorët e krizës së Perandorisë Osmane; - shpjegon përpjekjet e Perandorisë Osmane për daljen e saj nga kriza dhe faktorët e dështimit të këtyre përpjekjeve; - evidenton ndikimin e lëvizjeve nacionale në Ballkan në shpërbërjen e Perandorisë Osmane; - paraqet skematikisht hartën e re të Ballkanit, duke përcaktuar në të shtetet e reja të krijuara në shek. XIX – XX. **Bashkimi i Italisë** *Nxënësi:* - shpjegon ndikimin e iluminizmit dhe të romantizmit në lindjen e nacionalizmit; - përcakton në hartë fazat e realizimit të bashkimit të Italisë; - shpjegon faktorët e krijimit të shtetit të bashkuar italian; - gjykon mbi shprehjen “ Italinë e bëmë, tani të bëjmë italianët” **Gjermania**

	Nxënësi: - analizon rolin e Bismarkut në bashkimin e Gjermanisë; - evidenton strukturën e organizimit shtetëror në Gjermani; - shpjegon reformat sociale të Bismarkut në Gjermani, si fillesë e shtetit të mirëqenies sociale; - shpjegon tiparet e lëvizjeve punëtore në Gjermani duke evidentuar krijimin e grupimeve politike punëtore ; **Anglia drejt demokracisë liberale** *Nxënësi:* - shpjegon përpjekjet e shoqërisë angleze për reformimin e sistemit elektoral; - analizon tiparet e lëvizjeve politike dhe sociale në Angli; - evidenton kërkesat e lëvizjes feministe në Angli.
KONCEPTE DHE TERMA Absolutizëm, iluminizëm; merkantilizëm, kapitalizëm, kolonializëm, metropol, koloni, zgjerimi i tregjeve botërore, revolucion, zhvillim i vrullshëm, luftë civile, protektorat, restaurim, kompromis, kushtetutë, liri, federatë, konfederatë, barazi, vëllazëri; "Revolucion i Lavdishëm" Revolucion Politik, Revolucion Industrial, romantizëm, nacionalizëm, komb-shtet, demokraci liberale, liberalizëm; internacionalja e Parë, shtet i mirëqenies sociale, lëvizje punëtore, lëvizje feministe, e drejta elektorale.	
VEPRIMTARI TË SUGJERUARA PËR TEMATIKËN "KOHA E NDRYSHIMEVE THELBËSORE" **Shkëmbimet tregtare midis Evropës dhe "Botës së re"** - Analizon ndryshimet që sollën zbulimet gjeografike në ekonomi dhe në shkencë; - Përshkruan ndikimin e shkëmbimeve tregtare atlantike në jetën ekonomike, shoqërore dhe kulturore të vendeve evropiane dhe kolonive.	

Monarkë të tjerë iluministë: Maria Tereza; Frederiku i Madh

- Diskuton mbi reformat e këtyre monarkëve dhe ndryshimet që rrodhën prej tyre;
- Krahason politikat e monarkëve iluministë me sundimtarët absolutistë të shekujve të mëparshëm, duke vlerësuar përparimin institucional dhe social.

Romantizmi, iluminizmi dhe nacionalizmi

- Diskuton për përfaqësuesit dhe tiparet e secilës prej ideologjive të mësipërme
- Analizon ndikimin e këtyre rrymave në formimin e identitetit kombëtar, zhvillimin e arteve dhe ndryshimet politike në shek. XVIII–XIX.

4.2.5 Tematika: Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945)

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS	
Përmes kësaj tematike nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi tronditjet dhe krizat që çuan në fillimin e luftërave botërore. Nxënësit kuptojnë, analizojnë dhe gjykojnë për shkaqet dhe pasojat e Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore. Nxënësit gjykojnë dhe mbajnë qëndrim për pasojat e holokaustit, vlerësojnë trashëgiminë e luftërave botërore në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore të qytetërimit botëror. Kjo tematikë i mëson nxënësve përpjekjet e bëra për kapërcimin e krizave veçanërisht atyre ekonomike, si dhe krijon te ata bindjen se çdo konflikt rajonal apo me shtrirje më të gjerë sjell kosto negative për të ardhmen e shoqërisë. Tematika krijon një tablo të qartë për drejtimet e ndryshme në fushën e artit, kulturës dhe mënyrave të jetesës në shoqërinë dy sistemeve (demokratike dhe totalitare). Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar edhe veprimtari praktike të cilat jepen në rubrikën "Veprimtari të sugjeruara për tematikën". Këto orë veprimtarish mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës.	
KLASA 10	**KLASA 10**

NJOHURITË	REZULTATET E TË NXËNIT (*Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës*)
- **Fillimet e krizave të shek. XX. Lufta dhe paqja (1914-1920)** - **Bashkimi Sovjetik (BRSS)** - **Fashizmi në Itali** - **Gjermania** - **SHBA, modeli i një shteti liberal** - **Franca** - **Turqia, krijimi i një shteti laik kombëtar** - **Lufta e Dytë Botërore (1939-1945)**	**Fillimet e krizave të shek. XX. Lufta dhe paqja (1914-1920)** *Nxënësi:* - analizon shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Parë Botërore; - përcakton në hartë frontet kryesore në të cilat u zhvillua Lufta e Parë Botërore; - analizon konceptin e planit të SHBA-së për paqen në botë (14 pikat e Ëillsonit); - gjykon mbi vendimet më të rëndësishme të Konferencës së Paqes së arritur në Versajë; - pasqyron hartën e re politike të Evropës pas Luftës së Parë Botërore. - gjykon pasojat politike, ekonomike, sociale dhe psikologjike të Luftës së Parë Botërore dhe të traktateve të paqes në përfundim të saj. **Bashkimi Sovjetik (BRSS)** *Nxënësi:* - shpjegon shkaqet dhe rrjedhojat e revolucionit të vitit 1917 në Rusi; - analizon shkaqet e ardhjes në pushtet të qeverive totalitare në Bashkimin Sovjetik, - analizon tiparet e sistemit politik në BRSS;

	- analizojë politikën e Stalinit si pika kulmore e zbatimit të diktaturës së proletariatit dhe të luftës së klasave; - gjykon mbi tiparet e sistemit ekonomik në BRSS; - analizon tiparet social-kulturore të shoqërisë totalitare në BRSS; **Fashizmi në Itali** *Nxënësi:* - shpjegon kushtet historike të ardhjes në pushtet të Musolinit; - analizon tiparet e sistemit politik në Italinë fashiste; - shpjegojë tiparet e politikës së jashtme dhe të brendshme të fashizmit në Itali; - analizon tiparet e sistemit ekonomik në Italinë fashiste; - analizon tiparet social-kulturore të shoqërisë në Italinë fashiste; shpjegon kushtet historike të ardhjes në pushtet të Hitlerit; - analizon tiparet e politikës së jashtme dhe të brendshme të nazizmit në Gjermani; - gjykon antisemitizmin e Hitlerit, që solli holokaustin, duke gjykuar për rrjedhojat e tij; - analizon arsyet e militarizimit të ekonomisë si faktor për daljen nga kriza ekonomike; **SHBA, modeli i një shteti liberal** *Nxënësi:*

	- analizon tiparet e sistemit politik në SHBA; - analizon shkaqet dhe tiparet e krizës së viteve 1929 – 1933 në SHBA; - gjykon mbi "Kursin e Ri të Rusveltit si model për të dalë nga kriza ekonomike; - analizon strukturën e shoqërisë amerikane në periudhën midis dy luftërave botërore duke shqyrtuar aspektet e jetës së përditshme; - analizon shkaqet, synimet dhe arritjet e lëvizjeve feministe në SHBA, duke evidentuar përpjekjet e tyre për barazi sociale dhe politike; **Franca** *Nxënësi:* - analizon tiparet e sistemit politik në Francë; - analizon tiparet e sistemit ekonomik në Francë; - analizon shkaqet, tiparet e krizës së viteve 1929 – 1933 në Francë dhe rrugët e daljes nga kriza; - analizon tiparet social-kulturore të shoqërisë në Francë; **Turqia, krijimi i një shteti kombëtar laik** *Nxënësi:* - vlerëson rolin e Qemal Ataturkut në krijimin e shtetit laik kombëtar turk; - analizon reformat e Ataturkut në evropianizimin e Turqisë; - analizon strukturën e shoqërisë turke në periudhën midis dy luftërave botërore duke vlerësuar ndryshimet që ajo pësoi;

	Lufta e Dytë Botërore(1939-1945) *Nxënësi:* - shpjegon shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe karakterin e saj; - përcakton në hartë frontet kryesore të Luftës së Dytë Botërore; - shpjegon rolin e grupeve të rezistencës gjatë Luftës së Dytë Botërore. - analizon trashëgiminë e Luftës së Dytë Botërore: ➢ pasojat ekonomike, ➢ pasojat sociale, ➢ pasojat psikologjike; ➢ pasojat e holokausti dhe të gjenocidit ndaj romëve.

KONCEPTET DHE TERMAT

Demokraci, komunizëm, fashizëm, antisemitizmi, nazizëm, imperializëm, social-demokraci, racizëm, proteksionizëm, mandat, protektorat, ekonomi socialiste, krizë ekonomike, shoqëri civile, diktaturë, diktatura e proletariatit, lufta e klasave; etatizëm; Stalinizmi; kult individi, Shteti i mirëqenies në Angli, Fronti Popullor në Francë, Marrëveshja e re (Kursi i ri i Rusveltit) në SHBA, kensianizmi.

VEPRIMTARI TË SUGJERUARA PËR TEMATIKËN "PERIUDHA TRONDITJEVE TË MËDHA (1914-1945)"

Ballkani në periudhën midis dy luftërave

- Përgatit një krahasim tematik (politik, ekonomik, social) mes dy ose më shumë vendeve të Ballkanit.
- Përdor burime historike për të interpretuar zhvillimet politike dhe ekonomike (dokumente historike, harta politike dhe statistika) për të ndërtuar një panoramë të qartë të rajonit gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave.
- Analizon tiparet e jetës politike në shtetet ballkanike pas Luftës së Parë Botërore

- Përshkruan karakteristikat e regjimeve politike në shtetet ballkanike (monarki, autoritarizëm, demokraci e brishtë).
- Identifikon tendencat e përbashkëta të destabilitetit politik (grushtet e shtetit, shtypjen e opozitës dhe mungesën e institucioneve demokratike të qëndrueshme).
- Dallon veçantitë e zhvillimeve politike në vende të ndryshme si Shqipëria, Jugosllavia, Greqia, Rumania, Bullgaria.
- Krahason zhvillimet ekonomike dhe sociale në vendet ballkanike
- Analizon gjendjen ekonomike të vendeve të Ballkanit pas Luftës së Parë Botërore (varësinë nga bujqësia, mungesën e industrializimit dhe krizën ekonomike të viteve '30).
- Vlerëson përpjekjet për reforma agrare, ndikimin e investimeve të huaja dhe varësinë nga tregjet perëndimore.
- Krahason përmasat e varfërisë, papunësisë dhe pabarazive shoqërore në vende të ndryshme.
- Analizon rolin e nacionalizmit në përkeqësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërshtetërore në Ballkan.
- Diskuton mbi tensionet midis grupeve etnike dhe pasojat e politikave të asimilimit apo përjashtimit të minoriteteve.
- Përshkruan marrëdhëniet midis shteteve të Ballkanit dhe krijimin e aleancave (Pakti Ballkanik (1934).
- Analizon ndikimin e fuqive të mëdha (Itali, Francë, Gjermani, BRSS) në çështjet e brendshme dhe marrëdhëniet rajonale.
- Reflekton mbi përpjekjet për ruajtjen e paqes në rajon dhe përballjen me kërcënimet e fashizmit dhe komunizmit në prag të Luftës së Dytë Botërore.
- Reflekton mbi trashëgiminë historike të kësaj periudhe për Ballkanin e sotëm
- Diskuton se si konfliktet, ndarjet etnike dhe kufijtë politikë të asaj kohe ndikojnë ende në marrëdhëniet dhe tensionet e Ballkanit bashkëkohor.
- Nxënësi propozon mënyra për të nxitur bashkëpunimin rajonal bazuar në mësimet e historisë.

Kontributi i shqiptarëve në mbrojtjen e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Vizitë (reale ose virtuale) në muzeun solemon në Berat, në muzeun "House of Leaves", Bunkart ose platforma ndërkombëtare si Yad Vashem.

- Përshkruan përndjekjen e hebrenjve nga regjimi nazist dhe përhapjen e politikave antisemite në Evropë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

- Përshkruan ideologjinë raciste të nazizmit dhe konceptin e "superioritetit arian" që çoi në përndjekjen e hebrenjve.
- Identifikon fazat kryesore të përndjekjes: diskriminimi ligjor (ligjet e nurembergut), izolimi në geto, deportimi dhe zhdukja masive në kampet e përqendrimit dhe shfarosjes.
- Reflekton mbi humbjet njerëzore dhe shkatërrimin e komuniteteve hebraike në shumë vende evropiane.
- Dallon situatën e veçantë në Shqipëri, ku hebrenjtë u strehuan dhe mbrojtën nga popullata vendase dhe autoritetet lokale.
- Analizon shkaqet dhe rrethanat që mundësuan mbrojtjen e hebrenjve nga shqiptarët
- Shpjegon rolin e traditës së besës, si dhe normave të mikpritjes dhe solidaritetit në shoqërinë shqiptare.
- Identifikon faktorët historikë, kulturorë dhe etikë që ndikuan në refuzimin e dorëzimit të hebrenjve tek autoritetet naziste apo kolaboracioniste.
- Përmend figurat shqiptare të shpallura "Të drejtë midis kombeve" nga Yad Vashem.
- Kupton rëndësinë e përpjekjeve për të ruajtur kujtesën historike përmes dokumentimit dhe nderimeve ndërkombëtare.
- Zhvillon ndjeshmëri qytetare ndaj padrejtësive dhe reflekton mbi përgjegjësinë individuale dhe kolektive në përballje me të keqen.
- Nxjerr mësime nga historia për të ndërtuar një kulturë të tolerancës dhe respektit për dallimet etnike, fetare dhe kulturore sot.
- Vlerëson rëndësinë e ruajtjes së kujtesës historike
- Propozon mënyra konkrete për të ruajtur këtë pjesë të historisë, si përmes ekspozitave, projekteve shkollore, apo bashkëpunimeve me muze dhe institucione.
- Përdor burime historike për të dokumentuar dhe analizuar kontributin shqiptar (lexon dëshmi, dokumente historike apo fragmente nga arkiva, dhe i përdor për të ndërtuar një përshkrim të bazuar në fakte të asaj periudhe.
- Përgatit një prezantim, poster ose ese për një rast konkret të ndihmës së dhënë një familjeje hebreje në Shqipëri.

Gjenocidi ndaj Romëve dhe Sintëve gjatë Luftës së Dytë Botërore

- Përshkruan përndjekjen sistematike të romëve dhe sintet nga regjimi nazist, duke theksuar se ata u konsideruan si "racë inferiore"; në ideologjinë raciste naziste dhe përfshiheshin në të njëjtën kategori të synuar për shfarosje si hebrenjtë.

- Shpjegon origjinën e stereotipeve dhe paragjykimeve ndaj romëve dhe sintet në Evropë përpara dhe gjatë regjimit nazist, si dhe mënyrën se si këto paragjykime u shfrytëzuan për justifikimin e përndjekjeve.
- Identifikon fazat e përndjekjes së tyre: diskriminimi institucional, arrestimi dhe internimi në kampe pune, përqendrimi dhe, në shumë raste, ekzekutimi masiv në kampet e shfarosjes si Auschëitz-Birkenau, ku u ndërtua një barakë e veçantë për romët ("Zigeunerlager").
- Reflekton mbi humbjet njerëzore dhe shkatërrimin e këtyre komuniteteve në shumë vende evropiane.

Gripi spanjoll

- Kupton kontekstin historik dhe përhapjen globale të gripit spanjoll.
- Përshkruan origjinën dhe mënyrën e përhapjes së gripit spanjoll në fund të Luftës së Parë Botërore.
- Identifikon përmasat e pandemisë dhe numrin e viktimave në shkallë botërore.
- Shpjegon se si pandemia ndikoi në jetën e përditshme të njerëzve, përfshirë kufizimet sociale, përhapjen e frikës dhe humbjet njerëzore.
- Analizon pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të gripit spanjoll në sistemet shëndetësore, marrëdhëniet shtet–qytetar dhe në kujtesën kolektive.
- Analizon ndikimin e pandemisë në jetën ekonomike dhe politike.
- Krahason gripin spanjoll me pandemi të tjera historike dhe bashkëkohore.
- I identifikon ngjashmëri dhe dallime ndërmjet gripit spanjoll dhe pandemisë së COVID-19, për sa i përket përhapjes, masave të marra dhe reagimit shoqëror.
- Vlerëson rëndësinë e transparencës, bashkëpunimit dhe veprimit të përbashkët në përballimin e fatkeqësive të përmasave globale.
- Ndërgjegjësohet mbi rëndësinë e përdorimit të burimeve të besueshme dhe informacionit shkencor gjatë pandemive.
- Reflekton mbi përgjegjësinë e individit në mbrojtjen e shëndetit të përbashkët.
- Kupton rëndësinë e mësimeve historike në përballimin e krizave të shëndetit publik.
- Reflekton mbi rëndësinë e solidaritetit, përgjegjësisë kolektive dhe rolit të shtetit
- Përdor burime historike dhe statistika për të hulumtuar mbi pandeminë

- Shfaq aftësi për të përmbledhur dhe paraqitur gjetje në mënyrë të qartë dhe të strukturuar. **Shoqëria, arti dhe kultura** - diskuton mbi tiparet social-kulturore të shoqërisë totalitare me ato të shoqërisë demokratike, duke gjykuar për këto tipare në plan krahasues; - diskuton mbi karakteristikat e artit dhe të kulturës gjatë gjysmës së parë të shek. XX;

4.2.6 Tematika: Qytetërimet bashkëkohore (1945 – sot)

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS	
Përmes kësaj tematike nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi zhvillimet politike, ekonomike e shoqërore të dy blloqeve të krijuara pas Luftës së Dytë Botërore, bllokut perëndimor dhe bllokut lindor. Nxënësit nëpërmjet modeleve të marra në studim analizojnë dhe krahasojnë tiparet politike, ekonomike dhe shoqërore të këtyre dy blloqeve. Ata vlerësojnë rolin dhe rëndësinë e Bashkimit Evropian, shpjegojnë prirjet e qytetërimeve sot, si ndryshime në strukturën sociale dhe zhvillimin e klasës së mesme, rritjen e rolit të gruas në qeverisje; globalizmin, uniformitetin, zhvillimin e shkencës, teknologjisë, kulturës, artit dhe arsimit, për të evidentuar prirjen dhe perspektivën e qytetërimeve të sotme. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar edhe veprimtari praktike të cilat jepen në rubrikën "Veprimtari të sugjeruara për tematikën". Këto orë veprimtarish mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika sëbashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës.	
KLASA 10 **NJOHURITË**	**KLASA 10** **REZULTATET E TË NXËNIT** **(*Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës*)**
- **Bota menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore (1945 – 1946)**	**Bota menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore (1945 – 1946)** *Nxënësi:*

- **BRSS gjatë viteve 1945 – 1990** - **ShBA gjatë viteve 1945 – 2000** - **Procesi i dekolonizimit** - **Italia gjatë viteve 1945 – 2000** - **Franca gjatë viteve 1945 – 2000** - **Britania e Madhe gjatë viteve 1945 – 2000** - **Gjermania gjatë viteve 1945 – 1991** - **Jugosllavia gjatë viteve 1945 – 1990** - **Blloku lindor gjatë viteve 1945 – 1989** - **Revolucionet demokratike në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore** - **Shpërbërja e BRSS dhe e Jugosllavisë** - **Bashkimi Evropian** - **Prirjet e qytetërimeve sot**	- analizon kushtet historike të krijimit, karakterin dhe qëllimet e OKB-së; - tregon procesin e arritjes së paqes dhe analizon vendimet kryesore të konferencës së Jaltës, Potsdamit dhe Parisit; - gjykon mbi ndryshimet që sollën këto vendime në botën e pasluftës; **BRSSS gjatë viteve 1945 – 1990** *Nxënësi:* - analizon tiparet e sistemit politik në BRSS; - analizon veçoritë e politikave të brendshme dhe të jashtme të BRSS; - shpjegon marrëdhëniet e BRSS me bllokun lindor dhe bllokun perëndimor; - analizon tiparet e sistemit ekonomik në BRSS; - gjykon mbi tiparet social-kulturore të shoqërisë në BRSS; - arsyeton mbi rolin e udhëheqësve politikë në ndryshimet e politikave të brendshme dhe të jashtme; **SHBA gjatë viteve 1945 – 2000** *Nxënësi:* - analizon tiparet e sistemit politik në ShBA; - analizon veçoritë e politikave të brendshme dhe të jashtme të ShBA-së; - analizon tiparet e sistemit ekonomik në ShBA; - shpjegon marrëdhëniet e ShBA-së me bllokun perëndimor dhe BRSS; - gjykon mbi tiparet social-kulturore të shoqërisë në ShBA; - vlerëson rolin e lëvizjeve sociale në emancipimin e shoqërisë amerikane;

	- arsyeton mbi rolin e liderëve politikë në zhvillimet e brendshme dhe të jashtme; **Procesi i dekolonizimit** *Nxënësi:* - shpjegon kushtet historike në të cilat u zhvillua procesi i dekolonizimit; - përcakton në hartë lindjen e shteteve kombëtare si pasojë e procesit të dekolonizimit; - evidenton rrugët dhe veçoritë e realizmit të këtij procesi; - vlerëson rolin e elitës vendase në këtë proces; **Italia gjatë viteve 1945 – 2000** *Nxënësi:* - shpjegon rrugët dhe veçoritë e rimëkëmbjes politike dhe shoqërore të Italisë; - evidenton faktorët e "mrekullisë ekonomike" të Italisë; - shpjegon procesin e përfshirjes së Italisë në organizmat e përbashkëta Euroatlantike; **Franca gjatë viteve 1945 – 2000** *Nxënësi:* - analizon tiparet e sistemit politik, ekonomik dhe shoqëror në Francë; - evidenton qëndrimin e Francës ndaj procesit të dekolonizimit; - shpjegon procesin e përfshirjes së Francës në organizmat e përbashkëta Euroatlantike dhe evidenton rolin e saj si iniciatorë në Komunitetin Evropian të Çelikut dhe Qymyrit;

	Britania e Madhe gjatë viteve 1945 – 2000 *Nxënësi:* - analizon tiparet e sistemit politik, ekonomik dhe shoqëror në Britaninë e Madhe; - evidenton qëndrimin e Britanisë ndaj procesit të dekolonizimit; - shpjegon procesin e përfshirjes së Britanisë në organizmat e përbashkëta Euroatlantike; **Gjermania gjatë viteve 1945 – 1991** *Nxënësi:* - shpjegon procesin e krijimit të dy Gjermanive; - evidenton përplasjen e dy superfuqive në këtë proces; - shpjegon rrugët dhe veçoritë e rimëkëmbjes politike, ekonomike dhe shoqërore të Republikës Federale Gjermane; - shpjegon faktorët që çuan në integrimin e Republikës Federale Gjermane në organizmat e përbashkëta Euroatlantike; - shpjegon faktorët që çuan në bashkimin e dy Gjermanive; **Jugosllavia gjatë viteve 1945 – 1990** *Nxënësi:* - analizon tiparet e sistemit politik në Jugosllavi; - analizon veçoritë e politikave të brendshme dhe të jashtme të Jugosllavisë; - evidenton tiparet e politikes nacionale në Jugosllavi; - analizon tiparet e sistemit ekonomik dhe shoqëror në Jugosllavi;

	- shpjegon rolin e Jugosllavisë në organizimin e Lëvizjes së Vendeve të Paangazhuara; **Blloku lindor gjatë viteve 1945 – 1989** *Nxënësi:* - shpjegon rrugët e vendosjes së regjimeve komuniste në Evropën Qendrore dhe Lindore; - shpjegon dallimet dhe tiparet e përbashkëta të organizimit politik, ekonomik dhe shoqëror të shteteve socialiste të bllokut lindor; - evidenton lëvizjet politike dhe shoqërore të bllokut lindor për tu shkëputur nga varësia e BRSS; - shpjegon arsyet që çuan drejt integrimit ekonomik dhe politiko-ushtarak të shteteve të bllokut komunist; **Revolucionet demokratike në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore** *Nxënësi:* - shpjegon rrugën e transformimeve drejt demokracisë të shteteve ish-komuniste, duke evidentuar elementet e shoqërive demokratike post-komuniste; - evidenton në hartën politike të Evropës, ndryshimet territoriale pas rënies së murit të Berlinit; - evidenton dallimet dhe ngjashmërinë ndërmjet shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore në periudhën e tranzicionit; **Shpërbërja e BRSS dhe e Jugosllavisë**

	Nxënësi: - analizon shkaqet dhe rrjedhimet e ndryshimeve territoriale në Evropë: shpërbërja e BRSS-së dhe e Jugosllavisë, duke evidentuar si përfundim të procesit pavarësinë e Kosovës; **Bashkimi Evropian** *Nxënësi:* - evidenton Traktatin e Mahstritit, si vazhdues të procesit të integrimit evropian dhe krijuesin e Bashkimit Evropian; - vlerëson rolin dhe rëndësinë e Bashkimit Evropian; - liston në mënyrë skematike institucionet kryesore vendimmarrëse të Bashkimit Evropian, duke evidentuar misionin e tyre; - analizon procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian; **Prirjet e qytetërimeve sot** *Nxënësi:* - analizon format dhe mënyrat e ndryshme të jetesës në qytetërimet e sotme, duke gjykuar mbi raportet trashëgimi dhe tendencat e reja sot; - analizon arsyet e rritjes së rolit të gruas në jetën shoqërore dhe politike sot; - përcakton elementet e globalizmit, duke analizuar ndikimin e tyre në perspektivën e shoqërisë globale; - evidenton tiparet dhe prirjet e reja të artit, kulturës dhe arsimit;

	- evidenton prirjet e zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë drejt zbulimit të kozmosit, modernizimit dhe automatizimit të jetës.

KONCEPTET DHE TERMAT

Luftë e Ftohtë, Perde e Hekurt, superfuqi, revizionizëm, imperializëm, sovranitet i kufizuar, disident, bllok, detantë, dekolonizim, Commonëealth, bashkekzistencë paqësore, denazistifikim, çmilitarizim, të drejtat e njeriut, armë bërthamore, garë armatimesh, ekonomi mikse, globalizëm, hipi, integrim evropian, lëvizje antiraciale, lëvizje feministe, lëvizje studentore, shpërbërje, ost-politika, politikë dirizhiste, neokonservatorizëm, neoliberalizëm, socializëm me fytyrë njerëzore, vetë administrim, Glasnost, Perestrojkë, kursi i kufirit të ri, Korpusi i Paqes, terrorizëm, uniformitet, vende të paangazhuara.

VEPRIMTARI TË SUGJERUARA PËR TEMATIKËN "QYTETËRIMET BASHKËKOHORE (1945 – SOT)"

Konferenca e Helsinkit dhe të drejtat e njeriut.

- Shpjegon qëllimet, përmbajtjen dhe pasojat e Konferencës së Helsinkit në kontekstin e Luftës së Ftohtë.
- Vlerëson ndikimin e saj në rritjen e ndërgjegjes për të drejtat e njeriut në vendet e Lindjes.
- Gjykon mbi përpjekjet aktuale për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe kupton rëndësinë e mekanizmave ndërkombëtarë në këtë fushë.
- Evidenton rëndësinë e respektit për të drejtat universale për ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

Shqipëria në regjimin komunist

- Identifikon elementet thelbësore të shtetit totalitar: kontrolli i plotë i pushtetit nga partia, mungesa e opozitës, propagandë e përhapur dhe kult i individit.
- Shpjegon politikat e kolektivizimit të bujqësisë, shtetëzimit të pronës private dhe përqendrimit të ekonomisë në duart e shtetit.
- Përshkruan rolin e sigurimit të shtetit, burgosjet politike, kampet e internimit dhe persekutimin e kundërshtarëve të regjimit.
- Diskuton mbi izolimin ndërkombëtar të Shqipërisë dhe shkëputjen nga bashkimi sovjetik, kina dhe më pas nga çdo aleat i huaj.
- Diskuton mbi ndalimin e fesë dhe shpalljen e Shqipërisë.

- Analizon kufizimin e lirive të njeriut: lirinë e shtypit, të mendimit, të udhëtimit dhe të organizimit.
- Reflekton mbi pasojat afatgjata të regjimit komunist në shoqërinë shqiptare
- Kupton efektet e diktaturës në traumën kolektive, emigrimin, mungesën e besimit në institucionet shtetërore dhe trashëgiminë kulturore të shtrembëruar.
- Reflekton mbi nevojën për ruajtjen e kujtesës historike dhe rëndësinë e drejtësisë për viktimat e regjimit.
- Përdor burime historike dhe dëshmi për të analizuar periudhën komuniste (dokumente zyrtare, fjalime të kohës, dëshmi të të përndjekurve politikë, materiale arkivore dhe përdor burime multimediale për të ndërtuar një pamje të plotë të jetës nën diktaturë.)
- Shfaq aftësi kritike për të dalluar propagandën nga realiteti dhe për të analizuar mesazhet ideologjike të kohës.
- Krahason zhvillimin e komunizmit në Shqipëri me atë në vende si bashkimi sovjetik, kina, Rumania apo gjermania lindore, duke dalluar ngjashmëritë dhe veçantitë e izolimit shqiptar.
- Analizon përse Shqipëria përfundoi si një nga diktaturat më të izoluara dhe të rrepta të Evropës.

Vizitë mësimore në Bunk'Art dhe Shtëpinë e Gjetheve

- Kupton mekanizmat e kontrollit dhe frikës në regjimin komunist
- Përshkruan rolin e Sigurimit të Shtetit si instrument i kontrollit të brendshëm dhe shtypjes së kundërshtarëve politikë.
- Identifikon pajisjet dhe praktikat e përdorura për survejimin e qytetarëve (dëgjimi, ndjekja, agjentët e infiltruar), siç ekspozohen në Shtëpinë e Gjetheve.
- Reflekton mbi përvojën e të përndjekurve politikë dhe jetën nën diktaturë
- Përjeton në mënyrë emocionale e të ndërgjegjshme hapësirat e izolimit, dhunës dhe jetës së nënshtruar në sistemin e kamp-burgjeve dhe bunkerit të shtetit totalitar.
- Përshkruan me empati jetën e individëve të survejuar, të ndaluar apo të internuar dhe ndikimin e kësaj përvoje në jetën e tyre dhe të familjeve të tyre.

- Zhvillon aftësinë për të interpretuar burime muzeale dhe dëshmi historike
- Analizon dokumente, objekte autentike, fotografi, audio-dëshmi dhe arkiva të paraqitura në muze, duke i lidhur me temat e trajtuara në klasë.
- Aftësohet të lexojë dhe interpretojë të dhëna nga burime primare dhe sekondare historike në një kontekst konkret dhe vizual.
- Vlerëson rëndësinë e ruajtjes së kujtesës historike dhe të edukimit për demokracinë
- Diskuton mbi nevojën e përkujtimit të viktimave të regjimit dhe rolin e muzeve të kujtesës në edukimin qytetar.
- Reflekton mbi rëndësinë e lirisë së mendimit, të fjalës dhe të të drejtave të njeriut në një shoqëri demokratike.
- Shfaq aftësi për të bërë krahasime dhe nxjerrë mësime nga historia
- Krahason mënyrën si shteti komunist përdorte mekanizmat e frikës për ruajtjen e pushtetit me shembuj të ngjashëm nga vende të tjera të Evropës Lindore.
- Gjykon mbi rrezikun e autoritarizmit dhe vlerëson domosdoshmërinë e transparencës institucionale.

Republika e Pavarur e Kosovës

- Shpjegon zhvillimet historike që çuan në shpalljen e pavarësisë së Kosovës
- Identifikon ngjarjet kryesore që ndikuan në procesin e pavarësimit të Kosovës.
- Shpjegon arsyet politike, etnike dhe ndërkombëtare që çuan në shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008.
- Nxënësi vlerëson pasojat e shpalljes së pavarësisë për stabilitetin rajonal dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.
- Vlerëson rolin e aktorëve ndërkombëtarë në procesin e shtet formimit të Kosovës, (rolin e NATO-s, OKB-së, BE-së dhe SHBA-së në ndalimin e konfliktit dhe mbështetjen për krijimin e institucioneve në Kosovë.)
- Vlerëson njohjen ndërkombëtare të Kosovës dhe qëndrimet e shteteve që e kanë ose nuk e kanë njohur atë.
- Përdor burime historike për të formuluar qëndrime të argumentuara.
- Reflekton mbi rëndësinë e shtetësisë dhe sovranitetit dhe mbi sfidat e ndërtimit të një shteti funksional dhe demokratik në kontekstin e Kosovës pas vitit 2008.

Pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë

- Shpjegon se çfarë është një pakicë kombëtare dhe bën dallimin mes pakicave kombëtare dhe atyre etno-gjuhësore.
- Identifikon grupet e pakicave kombëtare në Shqipëri dhe zonat ku jetojnë.
- Përshkruan përhapjen gjeografike dhe kontributin e tyre në jetën sociale, kulturore dhe ekonomike të vendit.
- Vlerëson të drejtat që u garantohen pakicave kombëtare në fushat e arsimit, përdorimit të gjuhës, kulturës, medias dhe përfaqësimit politik.
- Argumenton pse është e rëndësishme që një shoqëri demokratike të njohë dhe të mbrojë identitetet e pakicave.
- Sjell shembuj nga vende të tjera dhe analizon modele të mira për përfshirjen dhe ruajtjen e identitetit të pakicave.
- Propozon mënyra për të luftuar stereotipet dhe për të ndërtuar një shoqëri përfshirëse dhe respektuese.
- Vlerëson vlerën e shumëllojshmërisë kulturore si pasuri për vendin.

Sfidat e shoqërisë së shekullit XXI

- Identifikon sfidat kryesore si: globalizimi, ndryshimet klimatike, zhvillimet teknologjike, pabarazitë ekonomike, migracioni, krizat shëndetësore dhe konflikti gjeopolitik.
- Përshkruan ndikimin që këto sfida kanë në jetën individuale, kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Analizon shkaqet dhe pasojat e sfidave globale dhe lokale
- Shpjegon lidhjen midis zhvillimeve teknologjike dhe ndryshimeve në tregun e punës, privatësisë dhe marrëdhënieve shoqërore.
- Analizon pasojat e krizës mjedisore dhe ndryshimeve klimatike në Shqipëri dhe më gjerë.
- Kupton shkaqet e emigracionit dhe ndikimin e tij në vendin e origjinës dhe të destinacionit.
- Përshkruan mënyra konkrete me të cilat të rinjtë mund të kontribuojnë në zgjidhjen e sfidave përmes veprimit individual dhe kolektiv.
- Vlerëson rëndësinë e bashkëpunimit global dhe të politikave për zhvillim të qëndrueshëm
- përshkruan rolin e institucioneve ndërkombëtare si OKB, BE, UNESCO në përballimin e krizave globale.
- Analizon objektivat e agjendës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm dhe mënyrën si ato prekin jetën e përditshme.

- Reflekton mbi rolin e qytetarit në përballimin e sfidave shoqërore
- Përdor burime të ndryshme për të hulumtuar mbi një sfidë të caktuar
- Mbledh dhe analizon të dhëna nga media, burime shkencore dhe raportet ndërkombëtare për një temë të zgjedhur (p.sh. Varfëria, e drejta për arsim, ndikimi i inteligjencës artificiale).
- Identifikon burimet e informacionit të besueshme dhe dallon propagandën apo lajmet e rreme në kontekstin e krizave shoqërore dhe zhvillon aftësi kritike për të dalluar informacionin e saktë nga dezinformimi
- Ndan gjetjet në formë prezantimi, posteri ose ese, duke argumentuar me të dhëna dhe fakte.

4.3 Qëndrime dhe vlera

Në lëndën e historisë nxënësi demonstron qëndrime dhe vlera të përmbledhura si më poshtë:

- Shfaq interes dhe kuriozitet të vazhdueshëm për historinë si dije dhe si mënyrë për të kuptuar botën.
- Vlerëson rëndësinë e kërkimit historik dhe tregon përkushtim për të eksploruar burime dhe ngjarje.
- Mbështet përdorimin e mendimit kritik gjatë përballjes me burime dhe demonstron dëshirë për të kuptuar më shumë.
- Pranon rëndësinë e dallimit mes fakteve dhe opinionit dhe respekton saktësinë e informacionit historik.
- Çmon rolin e burimeve historike në ndërtimin e një pasqyre objektive të së kaluarës.
- Vlerëson historinë si udhërrëfyes për të kuptuar të tashmen dhe për të ndërtuar të ardhmen.
- Vlerëson pozitën dhe trashëgiminë e qytetërimit shqiptar në kontekstin e historisë botërore.
- Shpreh mirënjohje dhe vlerësim për figurat historike që kanë ndikuar në zhvillimin e shoqërisë dhe identitetit kombëtar.
- Forcon ndjenjën e përkatësisë dhe krenarisë për identitetin kombëtar dhe e lidh atë me respektin për historinë kombëtare.
- Vlerëson trashëgiminë kulturore botërore si pasuri të përbashkët dhe si mjet për dialog ndërkulturor.
- Respekton larminë etnike dhe kulturore të shoqërisë dhe shfaq gatishmëri për të bashkëjetuar me dallimet.

- Shpreh krenari për vendin e tij/saj dhe njeh vlerat që sjellin kulturat e tjera në shoqëri.
- Pranon ekzistencën e interpretimeve të ndryshme historike dhe reflekton mbi shkaqet që i shkaktojnë ato.
- Respekton mendimet e ndryshme dhe demonstron ndershmëri intelektuale në përdorimin e informacionit.
- Shpreh lirisht mendimet dhe mbështet kreativitetin si pjesë të të nxënit historik.
- Tregon paanësi dhe drejtësi në mënyrën si i kupton dhe i interpreton ngjarjet historike.
- Pranon kritikat me qëndrueshmëri dhe i përdor ato për përmirësim personal dhe akademik.
- Dëshmon pavarësi dhe vetëbesim në procesin e të nxënit historik.
- Respekton përpjekjet dhe sukseset e të tjerëve dhe bashkëpunon me përgjegjësi në punën në grup.

5 METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Mësimdhënia e historisë në arsimin e mesëm të lartë synon të ndihmojë nxënësit të shkojnë përtej riprodhimit të fakteve dhe datave, duke ndërtuar kuptime të thelluara për zhvillimet historike dhe lidhjet mes së shkuarës dhe së tashmes. Historia nuk është thjesht një përmbledhje ngjarjesh, por një mënyrë për të kuptuar shoqërinë, identitetin dhe ndryshimet në kohë. Ajo shërben si një mjet për të formuar qytetarë të ndërgjegjshëm, kritikë dhe të ndjeshëm ndaj vlerave demokratike dhe njerëzore.

Mësimdhënia synon të zhvillojë kompetencat e lëndës, ***përfshirë aftësinë për kërkim historik, përdorimin e burimeve, analizën shkak–pasojë, interpretimin dhe shpjegimin e ngjarjeve historike, si dhe komunikimin e argumentuar të të kaluarës.*** Po ashtu, ***theksohet ndërtimi i koncepteve kyçe historike, si: kuptimi kronologjik, ndryshimi dhe vazhdimësia, diversiteti, empatia historike dhe rëndësia historike***. Përmes këtyre komponentëve, nxënësit mësojnë jo vetëm për ngjarjet, por edhe për mënyrat se si ato kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë në realitetin e sotëm.

📖 ***Të nxënit aktiv dhe kërkimor bazuar në zhvillimin e kompetencave.*** Nxënësit përfshihen në mënyrë aktive në procesin mësimor përmes analizës së burimeve historike, diskutimeve, ndërtimit të kohështrirjeve, hartave dhe projekteve kërkimore që nxisin mendimin kritik dhe ndërveprimin me informacionin historik.

Përmes pyetjeve thelbësore dhe situatave problemore, nxënësit stimulojnë aftësinë për të analizuar, krahasuar dhe interpretuar ngjarje nga e kaluara, duke ndërtuar qëndrime të reflektuara për çështje me rëndësi shoqërore dhe njerëzore.

📖 ***Argumentimi dhe komunikimi historik.*** Përdorimi i gjuhës së saktë historike, ndërtimi i argumenteve me bazë burimore dhe shprehja e qëndrimeve të mbështetura me fakte janë aftësi që zhvillohen në mënyrë të qëllimshme. Mësuesi udhëheq nxënësit të ndërtojnë narrativa historike dhe të zhvillojnë gjykim të pavarur.

📖 ***Mësimi dhe ruajtja në kujtesë.*** Një aspekt kyç i metodologjisë së historisë është edukimi për kujtesën historike dhe ndërgjegjësimin qytetar. Përveç nxjerrjes në pah të arritjeve pozitive të shekullit XX, si përdorimi paqësor i shkencës, zhvillimi i demokracisë dhe të drejtave të njeriut, është jetike që nxënësit të ndërgjegjësohen për ngjarjet shkatërrimtare si Holokausti, gjenocidet, krimet kundër njerëzimit, spastrimet etnike dhe regjimet totalitare. Për këtë qëllim, mësimdhënia historike duhet të:

- ndihmojë nxënësit të njohin faktet dhe shkaqet e këtyre ngjarjeve;
- promovojë reflektimin mbi ideologjitë që çuan në to;
- nxisë përkujtimin përmes datave zyrtare, si 27 janari (dita e Holokaustit) dhe 23 gushti (dita përkujtimore e viktimave të totalitarizmave);
- integrojë ndihmën e Këshillit të Evropës përmes përfshirjes në iniciativat ndërkombëtare për edukimin mbi Holokaustin dhe parandalimin e urrejtjes.

📖 ***Përdorimi i teknologjisë dhe burimeve digjitale.*** Në një botë ku të rinjtë janë të ekspozuar ndaj një fluksi të madh informacioni, teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit bëhen pjesë përbërëse e mësimdhënies së historisë. Ato:

- ofrojnë qasje të zgjeruar në burime origjinale dhe interpretime të shumëllojta;
- nxisin analizën e besueshmërisë së burimeve dhe zhvillimin e kompetencave digjitale kritike;
- ndihmojnë në bashkëpunimin dhe dialogun ndërkulturor nëpërmjet platformave ndërvepruese;
- kërkojnë nga mësuesit udhëzim të kujdesshëm për të luftuar përhapjen e përmbajtjeve raciste dhe për të respektuar lirinë e shprehjes me përgjegjësi.

- ***Të nxënit bashkëpunues dhe ndërdisiplinor.*** Nxënësit punojnë në grupe për të ndërtuar projekte që ndërthurin historinë me lëndë të tjera si gjeografia, arti, qytetaria dhe teknologjia. Kjo qasje ndërdisiplinore i ndihmon të kuptojnë historinë si pjesë e një sistemi të ndërlidhur të dijeve dhe përvojave.
- ***Përdorimi i stileve të të nxënit dhe vetëvlerësimi***. Nxënësit udhëzohen të njohin stilin e tyre të të nxënit dhe të përdorin metoda që i ndihmojnë të përvetësojnë konceptet në mënyrë të qëndrueshme, duke reflektuar vazhdimisht mbi progresin dhe gabimet.
- ***Zhvillimi i qëndrimeve pozitive dhe aftësive socio emocionale.*** Përmes trajtimit të temave historike që lidhen me drejtësinë, përkatësinë, bashkëjetesën dhe diversitetin, nxënësit mësojnë të kultivojnë empatinë, respektin për të tjerët, durimin, bashkëpunimin dhe vetëbesimin për të menduar në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme.
- Mësimdhënia e historisë në klasën e dhjetë duhet të zhvillohet si një proces i ndërgjegjshëm dhe gjithëpërfshirës, që nuk e sheh të kaluarën vetëm si dije për t'u memorizuar, por si një udhërrëfyes për ndërtimin e një të ardhmeje më të drejtë, më të vetëdijshme dhe më humane.
- ***Të nxënit bazuar në veprimtari praktike dhe projekte dhe lidhja e historisë me jetën reale.*** Historia lidhet ngushtë me jetën qytetare dhe kuptimin e fenomeneve aktuale përmes analizës së ngjarjeve të së kaluarës. Të nxënit përmes veprimtarive praktike dhe projekteve i ndihmon nxënësit të kuptojnë më mirë proceset historike dhe ndikimin e tyre në shoqërinë e sotme. Këto forma të të nxënit mund të përfshijnë: hulumtime mbi tema të trashëgimisë kulturore, organizimin e ekspozitave historike në komunitet, krijimin e rrëfimeve multimediale mbi figura dhe ngjarje historike, intervista me të moshuar për të dokumentuar kujtesën historike, apo simulime të ngjarjeve të rëndësishme për të kuptuar proceset vendimmarrëse në të kaluarën. Përmes këtyre përvojave, nxënësit zhvillojnë mendimin kritik, aftësinë për të punuar në grup, dhe ndjeshmërinë qytetare.
- ***Përfshirja dhe barazia në të nxënë.*** Mundësia për të përfituar nga përvojat e të nxënit në historisë duhet t'u ofrohet të gjithë nxënësve, pa përjashtim. Mësimdhënia duhet të bazohet në interesin më të lartë të fëmijës, duke garantuar trajtimin e barabartë me dinjitet dhe respekt për të gjitha dallimet, qofshin ato kulturore, sociale apo individuale.
- Gjatë orëve të ndryshme të mësimit, metodat e teknikat ndërthuren me njëra-tjetrën, aq sa shpesh nuk mund t'i dallosh kufijtë midis tyre, prandaj, vëmendja e veçantë e mësuesit duhet drejtuar te lidhja organike e metodave dhe e teknikave të veçanta që ai përdor brenda një ore

mësimi. Në ndihmë të zbatimit të këtyre metodologjive, në program parashtrohen një sërë veprimtarish të sugjeruara, të cilat i ndihmojnë nxënësit në zotërimin e kompetencave dhe në arritjen e rezultateve të të nxënit të parashikuara në program.

- Mësuesi duhet të tregojnë kujdes të veçantë që nxënësit të nxiten vazhdimisht të reflektojnë në mënyrë kritike mbi ecurinë e të nxënit dhe punës së tyre në shkollë dhe të transferojnë ata ç`ka kanë mësuar në situata jetësore brenda dhe jashtë shkollës.
- Mundësia për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga përvojat e lëndës së historisë ashtu si nga çdo lëndë tjetër në shkollë, duhet t'u ofrohet të gjithë nxënësve pa përjashtuar askënd për asnjë shkak. Mësimdhënia duhet të bazohet në interesin më të lartë të nxënësit dhe duhet të sigurojë trajtimin e barabartë me dinjitet e respekt të gjithsecilit.

5.1 Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e historisë

Një ndër mënyrat më kuptimplota për të nxitur interesin dhe për të ndërtuar një të kuptuar të thelluar historik në arsimin e mesëm të lartë është përfshirja e situatave reale dhe praktike nga jeta e përditshme në procesin e të nxënit. Kur nxënësit lidhen me histori përmes konteksteve që reflektojnë sfida aktuale shoqërore, zhvillime komunitare apo përvoja familjare, ata e kuptojnë se historia nuk është vetëm një rrëfim i së kaluarës, por një mjet i fuqishëm për të interpretuar të tashmen dhe për të ndërtuar të ardhmen.

Situatat praktike mund të përfshijnë, për shembull: studimin e ngjarjeve lokale përmes intervistimit të të moshuarve; analizimin e burimeve dokumentare për të kuptuar sesi janë marrë vendime të rëndësishme politike; krahasimin e migrimeve historike me ato moderne për të kuptuar ndikimet kulturore dhe sociale; apo projektimin e një ekspozite për trashëgiminë kulturore në bashkëpunim me muzeun lokal. Këto përvoja e bëjnë mësimin më angazhues dhe të prekshëm, duke i ndihmuar nxënësit:

- të kuptojnë vlerën funksionale të dijes historike në jetën qytetare, si mjet për të gjykuar me përgjegjësi, për të ndërtuar qëndrime demokratike dhe për të reflektuar mbi drejtësinë dhe liritë themelore;
- të zhvillojnë mendimin kritik, empatinë historike dhe aftësinë për të analizuar situata nga perspektiva të ndryshme kohore dhe kulturore;

- të ndërtojnë kompetenca të kërkimit dhe interpretimit të fakteve, duke u bërë qytetarë aktivë që ndërveprojnë në mënyrë të vetëdijshme me historinë dhe pasojat e saj në shoqërinë moderne.

Shembull i një situate të nxëni në klasën X

Tema e orës: Trashëgimia kulturore në qytetërimet e lashta
Situata e të nxënit: *Mësuesi nis orën duke shfaqur në ekran ose duke treguar një imazh të fundit nga një lajm në internet që pasqyron dëmtimin ose restaurimin e një monumenti antik në Shqipëri (p.sh., Amfiteatri i Durrësit ose qyteti antik i Apolonisë).* Ai i drejtohet klasës me pyetjet: - *A keni vizituar ndonjë monument të lashtë si këto?* - *Pse mendoni se këto vende janë kaq të rëndësishme për ne sot?*
Pas disa komenteve nga nxënësit, mësuesi shton: Sot do të flasim për trashëgiminë kulturore të qytetërimeve të lashta dhe mënyrën si ajo ka mbijetuar deri në ditët tona. Ato nuk janë thjesht rrënoja, por dëshmi të historisë dhe të identitetit tonë.
Qasje metodologjike: *Përdorimi i situatave reale, diskutim i udhëzuar, konkretizim përmes imazheve.*
Nxënësit aftësohen të:
- zhvillojnë kompetenca historike, përmes përdorimit të burimeve historike dhe analizës së lidhjes ndërmjet së kaluarës dhe të tashmes;
- vlerësojnë rëndësinë e trashëgimisë kulturore si pjesë e historisë dhe identitetit të tyre;
- dallojnë ndikimin e qytetërimeve të lashta në jetën bashkëkohore;
- zhvillojnë ndjenjën e vlerësimit dhe përgjegjësisë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore;
- forcojnë ndjenjën e përkatësisë dhe të identitetit kombëtar.
Në këtë mënyrë, historia nuk mbetet një lëndë që mësohet përmes datash dhe emrash, por shndërrohet në një udhëtim të gjallë kërkimi dhe reflektimi, që i ndihmon nxënësit të kuptojnë më thellë identitetin, shoqërinë dhe rolin e tyre në të. Ajo bëhet një urë lidhëse mes të shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes, duke fuqizuar formimin qytetar dhe përgatitjen për një jetë sociale të ndërgjegjshme e të informuar.

5.2 Roli i veprimtarive praktike dhe projekteve kurrikulare në lëndën e historisë

Veprimtaritë praktike dhe projekti kurrikular shërbejnë si mjete të fuqishme për të ndihmuar nxënësit në përvetësimin më të thelluar të përmbajtjes historike, duke e bërë atë më konkrete, më të kuptueshme dhe më të lidhur me jetën e tyre të përditshme. Përmes këtyre formave mësimore, nxënësit mësojnë jo vetëm "çfarë ka ndodhur", por edhe si të mësojnë për historinë, duke përdorur burime të ndryshme, duke analizuar, diskutuar dhe ndërtuar mendime personale mbi ngjarjet dhe figurat historike. Në programin e historisë, veprimtaritë praktike janë të sugjeruara për çdo njësi tematike, ndërsa projekti kurrikular paraqitet si një qasje ndërdisiplinore që shërben edhe si pjesë e procesit të vlerësimit të nxënësit, duke nxitur bashkëpunimin, kreativitetin dhe të nxënit e integruar. Përmes tyre, mësuesi dhe hartuesi i tekstit kanë mundësi të lidhin historinë me fusha të tjera të të nxënit dhe me temat ndërkurrikulare, duke krijuar një përvojë të pasur dhe të integruar për nxënësit.

Veprimtaritë praktike dhe projekti kurrikular nuk janë vetëm mjete për përvetësimin e përmbajtjes, por edhe hapësira ku nxënësit zhvillojnë mendim kritik, ndjeshmëri qytetare dhe aftësi për të reflektuar mbi sfidat e shoqërisë. Ato ndihmojnë në formimin e një këndvështrimi të pavarur dhe argumentues mbi të kaluarën, të tashmen dhe ndikimet e saj në të ardhmen.

Shembuj të veprimtarive dhe projektit kurrikular mund të përfshijnë:

- krijimin e një ekspozite mbi historinë lokale ose trashëgiminë kulturore të komunitetit;
- hulumtime mbi ngjarje të rëndësishme të historisë kombëtare dhe krahasimi i tyre me zhvillime të ngjashme ndërkombëtare;
- ndërtimi i linjës kohore dhe interpretimi i hartave historike që tregojnë ndryshimet gjeopolitike në kohë;
- intervista me të moshuar për dokumentimin e kujtesës historike;
- produkte digjitale si prezantime, video dokumentarë ose rrëfime vizuale që ilustrojnë figura apo ngjarje historike.

Këto veprimtari dhe projekte kontribuojnë në:

- zhvillimin e kompetencave historike dhe qytetare;
- ushtrimin e mendimit kritik dhe zgjidhjen e problemeve në kontekste historike;
- ndërtimin e identitetit kombëtar dhe kuptimin e ndikimeve ndërkulturore;

- përshtatjen e përmbajtjes dhe metodave për nxënësit me nevoja të veçanta dhe ofrimin e detyrave të avancuara për nxënësit e talentuar;
- reflektimin mbi sfidat bashkëkohore si krizat ekonomike, pandemitë, zhvillimet teknologjike dhe ndryshimet sociale, nëpërmjet lenteve të së kaluarës.

Roli i mësuesit në këtë proces është udhëheqës dhe mbështetës. Mësuesi ndihmon nxënësit në formulimin e pyetjeve historike, në planifikimin e projektit, në analizimin e burimeve të besueshme dhe në prezantimin e përfundimeve të tyre në mënyrë të qartë dhe të argumentuar. Ai gjithashtu udhëzon integrimin e përmbajtjeve të historisë me fusha të tjera të të nxënit, si gjeografia, letërsia, arti, teknologjia dhe edukimi qytetar. Veprimtaritë praktike dhe projekti kurrikular e shndërrojnë historinë në një lëndë të gjallë dhe të prekshme, që lidhet drejtpërdrejt me realitetin, nxit reflektimin mbi të kaluarën dhe përgatit nxënësit për të qenë qytetarë të vetëdijshëm, aktivë dhe të përfshirë në shoqëri.

5.2.1 Shembull i një veprimtarie praktike për klasën X

Titulli i veprimtarisë: Jeta e përditshme dhe kultura në Evropën mesjetare
Produkti final: Ekspozitë me titull "Jeta e përditshme në Evropën mesjetare", ku paraqiten postera, ditarë imagjinarë, harta konceptuale, si dhe punime me karakter krahasues mbi aspekte të ndryshme kulturore të qytetërimeve mesjetare.
Detyrat sipas rezultateve të të nxënit dhe grupeve të punës
1. Përshkruan zhvillimin e qyteteve dhe të tregtisë në Evropën mesjetare
➞ ***Grupi 1: Krijimi i hartës tregtare*** Nxënësit e grupi të parë, krijojnë një hartë të qyteteve tregtare më të rëndësishme të mesjetës, duke përshkruar rolin e tyre në zhvillimin e ekonomisë dhe jetës urbane. Ata shkruajnë gjithashtu një njoftim imagjinar për një panair mesjetar, ku përshkruhen mallrat, tregtarët dhe aktivitetet që zhvilloheshin në këto tregje.
2. Krahason mënyrën e jetesës së shtresave të ndryshme shoqërore në Evropën mesjetare
➞ ***Grupi 2: Ditar imagjinar/role-play***

Nxënësit e grupi të dytë, shkruajnë një faqe ditari nga perspektiva e një kalorësi, murgu, fshatari dhe tregtari. Më pas, përmes prezantimeve, ata krahasojnë mënyrat e jetesës duke evidentuar ndryshimet dhe ngjashmëritë mes shtresave shoqërore. Ditarët ngjiten në një fletë të formatit A3 (flipchart) si pjesë e ekspozitës.
3. Evidenton tiparet e zhvillimit të artit, të kulturës dhe të arsimit në qytetërimet mesjetare
➞ ***Grupi 3**: **Krijimi i një posteri vizual***   Nxënësit e grupi të tretë, realizojnë një poster vizual që pasqyron arkitekturën gotike dhe romanike, simbolet e artit fetar dhe institucionet e hershme arsimore. Ata përdorin vizatime, fotografi dhe shpjegime të shkurtra, duke përfshirë gjithashtu citate të mendimtarëve mesjetarë.
4. Gjykon për rolin e fesë në qytetërimet mesjetare
➞ ***Grupi 4: Diskutim dhe argumentim***   Nxënësit e grupit të katërt zhvillojnë një diskutim të strukturuar mbi ndikimin e fesë në arsimin dhe shkencën gjatë mesjetës, duke sjellë shembuj dhe argumente të mbështetura në fakte historike. Gjetjet dhe argumentet prezantohen para klasës dhe hidhen në një flipchart si pjesë e ekspozitës.
5. Krahason prirjet e zhvillimit të artit, të kulturës dhe të arsimit ndërmjet qytetërimit arab dhe qytetërimeve evropiane
➞ ***Grupi 5: Diagrami i Venit***   Nxënësit e grupi të pestë, ndërtojnë një diagram Veni për të krahasuar qytetërimin arab me qytetërimet evropiane në katër fusha: arti, arkitektura, shkenca dhe arsimi. Në pjesën qendrore vendosin ngjashmëritë, ndërsa në pjesët anësore shënojnë veçoritë e secilit qytetërim.
6. Organizimi i ekspozitës në klasë
Në përfundim *të punës së grupeve,* ***organizohet një ekspozitë në klasë*** ku secili grup paraqet produktin e vet: harta tregtare, ditarët imagjinarë, posteri vizual, diskutimi me argumente dhe diagrami i Venit**.** Nxënësit ndërveprojnë si "vizitorë të ekspozitës**"**, duke lënë komente apo pyetje për çdo stendë.
7. Reflektim personal

Në fund të orës, çdo nxënës plotëson një ***reflektim individual*** për pyetjet:

- "Çfarë më befasoi më shumë nga jeta në Mesjetë?"
- "Cilët elementë të Mesjetës kanë ndikim edhe sot në kulturën tonë?"

8. Vlerësimi i veprimtarisë

Më poshtë është një model vlerësimi i veprimtarisë praktike mbi temën *"Jeta e përditshme dhe kultura në Evropën mesjetare"*, i ndërtuar mbi rezultatet e të nxënit dhe i kategorizuar sipas niveleve të arritjes.

Ky format vlerësimi mund të përdoret nga mësuesi për të vlerësuar individualisht çdo nxënës ose grup pune në bazë të kontributit në ekspozitë dhe në prezantim.

Rezultati i të nxënit	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët
Përshkruan zhvillimin e qyteteve dhe të tregtisë në Evropën mesjetare	Jep një përshkrim të qartë dhe të detajuar të qyteteve dhe rrjeteve tregtare mesjetare, duke përfshirë shembuj konkretë dhe lidhje me zhvillimin urban dhe ekonomik	Jep një përshkrim të saktë të qyteteve dhe tregtisë me disa shembuj ilustrues	Jep një përshkrim të pjesshëm dhe të përgjithshëm, me pak shembuj ose pa i lidhur plotësisht me zhvillimin urban	Nuk e përshkruan qartë zhvillimin e qyteteve dhe tregtisë ose jep informacion të gabuar
Krahason mënyrën e jetesës së shtresave të ndryshme shoqërore në Evropën mesjetare	Bën një krahasim të thelluar dhe të argumentuar mes shtresave shoqërore, me shembuj specifikë dhe analizë të dallimeve dhe ngjashmërive	Bën një krahasim të qartë dhe të kuptueshëm me disa shembuj të mirë	Bën një krahasim sipërfaqësor, me pak të dhëna ose shembuj të përgjithshëm	Nuk arrin të krahasojë qartë ose i përzien karakteristikat e shtresave

Evidenton tiparet e zhvillimit të artit, të kulturës dhe të arsimit në qytetërimet mesjetare	Identifikon dhe shpjegon në mënyrë të saktë dhe të pasur elementet kryesore të artit, kulturës dhe arsimit me referenca konkrete	Identifikon tiparet kryesore me një nivel të mirë saktësie dhe sqarimi	Përmend disa elemente, por pa sqarim të thelluar ose me pasaktësi të vogla	Jep informacion të paplotë ose të pasaktë për aspektet kulturore
Gjykon për rolin e fesë në qytetërimet mesjetare	Jep një vlerësim kritik dhe të argumentuar për ndikimin e fesë, duke përfshirë shembuj dhe perspektiva të ndryshme	Jep një vlerësim të saktë dhe të qartë për ndikimin e fesë në shoqëri dhe dije	Jep një gjykim të përgjithshëm dhe jo shumë të mbështetur në fakte	Nuk e trajton rolin e fesë në mënyrë të kuptueshme ose jep gjykime të pasakta
Krahason prirjet e zhvillimit të artit, të kulturës dhe të arsimit ndërmjet qytetërimit arab dhe qytetërimeve evropiane	Bën një krahasim të pasur, të strukturuar dhe të saktë, duke përdorur shembuj domethënës nga të dy qytetërimet	Bën një krahasim të qartë me disa elemente të identifikuara saktë	Krahason në mënyrë të përgjithshme pa thellim të mjaftueshëm	Nuk arrin të krahasojë në mënyrë funksionale ose jep informacion të pasaktë

Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e historisë do të përshkruhen veprimtari praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënit sipas tematikave të lëndës.

5.2.2 Shembull i një projekti në klasën X

Projekti: Jeta në shekullin XXI, sfidat dhe transformimet që po formësojnë botën tonë
Qëllimi i projektit: Të ndihmojë nxënësit të analizojnë sfidat më të mëdha të shekullit XXI, duke i parë ato në vazhdimësi me ngjarje të së shkuarës dhe në funksion të së ardhmes. Përmes punës në grup, krahasimit historik, reflektimit kritik dhe përdorimit të burimeve vizuale, nxënësit kuptojnë më mirë rolin e dijes historike dhe zhvillimeve teknologjike në ndërtimin e një shoqërie të ndërgjegjshme dhe të qëndrueshme.
Produkti final: Ekspozitë tematike me titull "Shekulli XXI në pasqyrë", një galeri idesh dhe mesazhesh përmes posterave grafikë, eseve reflektuese, videove të inskenuara, kolazheve digjitale dhe hartave konceptuale që eksplorojnë sfidat më të mëdha të kohës sonë dhe rolin e historisë për t'i kuptuar e përballuar ato.
Detyrat sipas rezultateve të të nxënit dhe grupeve të punës
1. Krahason pandemi historike dhe bashkëkohore, duke analizuar ndikimin e tyre në jetën shoqërore dhe duke reflektuar mbi mësimet që historia ofron për përballimin e krizave të ngjashme.
➞ ***Grupi 1:*** Panel grafik me linjë kronologjike dhe ese reflektuese Nxënësit e grupit të parë hartojnë një panel kronologjik që ilustron shpërthimin dhe reagimet ndaj tri pandemive: COVID-19, Murtaja e Zezë dhe Gripi Spanjoll, përmes ikonografisë dhe statistikave përkatëse. Ata paraqesin krahasime vizuale mbi përhapjen dhe ndikimin social, ekonomik dhe politik të tri pandemive. Në vijim, ata përgatisin një ese reflektuese që shqyrton sesi mësimet nga e kaluara mund të udhëheqin përballjen me krizat shëndetësore të së ardhmes.
2. Analizon ndikimin e rreziqeve natyrore dhe ndryshimeve klimatike në jetën shoqërore, si dhe rolin e institucioneve në menaxhimin e tyre.
➞ ***Grupi 2: Poster dhe skenar imagjinar për reagimin komunitar*** Nxënësit e grupit të dytë analizojnë pasojat e përmbytjeve, tërmeteve, zjarreve dhe ngrohjes globale, duke i ilustruar me shembuj nga historia dhe realiteti bashkëkohor. Ata përfshijnë gjithashtu raste historike si dimri vullkanik i vitit 536 dhe viti 1816 "viti pa verë", duke reflektuar mbi

ndikimin social dhe ekonomik të këtyre ngjarjeve ekstreme klimatike. Ata realizojnë një poster me harta, grafika dhe statistika mbi përhapjen dhe ndikimin e rreziqeve natyrore dhe një skenar imagjinar për një strategji komunitare përballë një rreziku natyror në nivel lokal, ku përcaktojnë rolet e aktorëve institucionalë dhe komunitarë në menaxhimin e krizës.
3. Krahason kriza ekonomike dhe politike të shekujve XX–XXI dhe analizon ndikimin e tyre në jetën e përditshme dhe në zhvillimet sociale.
➞ ***Grupi 3**: Analizë grafike dhe podkast i inskenuar* Nxënësit e grupi të tretë, realizojnë një analizë grafike krahasuese me të dhëna për krizën e vitit 1929 dhe atë të vitit 2007-2008, duke theksuar ndikimin në grupe të ndryshme sociale. Ata prodhojnë një podkast të inskenuar me "zëra" të qytetarëve që përshkruajnë përvojat e tyre gjatë krizave dhe reflektimet mbi drejtësinë sociale dhe ekonomike.
4. Analizon ndikimin e teknologjisë në jetën bashkëkohore dhe parashikon tendenca të së ardhmes në komunikim, arsim dhe marrëdhënie njerëzore.
➞ ***Grupi 4: Faqe digjitale dhe ditar imagjinar*** Nxënësit e grupit të katërt analizojnë ndikimin e internetit, rrjeteve sociale dhe inteligjencës artificiale në jetën e përditshme, duke zhvilluar një diskutim të strukturuar për efektet pozitive dhe negative të tyre në komunikim, arsim dhe marrëdhënie ndër njerëzore. Si pjesë e përgatitjes, ata mund të shikojnë dokumentarin "The Social Dilema" për të reflektuar mbi varësinë ndaj teknologjisë dhe manipulimin e informacionit. Ata hartojnë një faqe digjitale (në formën e një blogu ose mini-website) ku përmbledhin ndikimin e teknologjisë përmes artikujve të shkurtër, sondazheve dhe ilustrimeve dhe një ditar imagjinar për vitin 2035, ku përshkruhet një ditë tipike e një të riu në një shoqëri të teknologjizuar. Të dy produktet prezantohen në klasë dhe afishohen në flipchart si pjesë e ekspozitës.
5. Ndërton lidhje ndërmjet ngjarjeve historike dhe sfidave të sotme, duke reflektuar mbi rëndësinë e dijes historike për qytetarinë demokratike.
➞ ***Grupi 5: Hartë konceptuale dhe fletë propagandistike historike (poster me mesazhe qytetarie)***

Nxënësit e grupi të pestë, përgatisin një hartë konceptuale, ku lidhen ngjarje të së kaluarës me sfida bashkëkohore si migracioni, ndryshimet klimatike apo konflikti. Ata krijojnë gjithashtu një fletë propagandistike historike/poster, që përmban mesazhe qytetarie aktive dhe reflektim mbi rolin e edukimit historik në ndërtimin e demokracisë. (poster me citate, pyetje dhe ide për qytetarinë aktive të informuar nga historia.)
6. Ekspozita
Në përfundim të punës së grupeve, organizohet një ekspozitë në klasë ku çdo grup prezanton punimin e tij. Nxënësit vizitojnë stendat e njëri-tjetrit dhe ndërveprojnë me secilën stendë përmes komenteve, pyetjeve ose vlerësimeve të shkruara.
7. Reflektimi
Në fund të veprimtarisë, çdo nxënës plotëson një fletë reflektimi personal me pyetjet: - Cila nga sfidat e trajtuara më tronditi ose më bëri të mendoj ndryshe për botën ku jetoj? Pse? - Çfarë më mësoi historia për të ardhmen time? - Cilën ide do të doja t'i tregoja një miku tim pas këtij projekti? - Si mund të ndikojë historia dhe teknologjia në përballimin e sfidave të ardhshme? - Si më ndryshoi ky projekt mënyrën si shoh botën?

5.3 Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e historisë

Nxënësit me nevoja të veçanta

Organizimi i kurrikulës sipas kompetencave, në fusha të nxëni, në shkallë, dhe me fokus integrimin u krijon mësuesve hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënit e tyre. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motivim, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. Në disa raste duhen bërë përshtatje të kurrikulës sipas diferencave të zhvillimit brenda një grupi moshor. Mësuesit mund të zgjerojnë zhvillimin e kompetencave kyçe si ato të komunikimit, të menduarit dhe shoqërore sipas nevojave individuale të nxënësve, për të zvogëluar dhe zhdukur diferencat brenda një shkalle të kurrikulës, në fund të saj.

- ***Nxënësit me vështirësi në të nxënë***

Shumë nxënës me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënit njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të kompetencës, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta. Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

- ***Nxënësit e talentuar***

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar. Mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zhvillojnë në mënyrë të vazhdueshme elemente specifikë të kompetencave kyçe (p.sh.: aftësitë e nivelit të lartë konjitiv të kompetencës të të menduarit) dhe specifike të fushës, të fokusohen në çështjet kros-kurrikulare, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënit brenda dhe jashtë shkollës.

6 VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi është një aspekt i rëndësishëm i lëndës së historisë. Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënit bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies, i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave., fokusohet në matjen e njohurive e aftësive, në arritjen e rezultateve të të nxënit, dhe në nivelin e përmbushjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi, e ndihmon mësuesin të evidentojë përparimin e nxënësve, të vlerësojë se sa të përshtatshme e të dobishme janë metodat e mësimdhënies që ai përdor, të përmirësojë mësimdhënien dhe të pajisë nxënësit me informacionin përkatës për progresin e tyre.

Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm që i shërben nxënësve për të ndjekur vetë ecurinë e tyre në këtë lëndë, për të njohur anët e tyre të forta dhe vështirësitë që hasin në zotërimin e njohurive dhe kompetencave, në mënyrë që të punojnë përkatësisht për përforcimin dhe kapërcimin e tyre. Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm edhe për prindërit, me anë të të cilit ata mund të ndihmojnë më mirë në edukimin e fëmijëve të tyre.

I domosdoshëm është vlerësimi i përmbajtjes të lëndës lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive historike nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre. (*p.sh. vetëvlerësimi, intervistë me një listë treguesish, testi objektiv, vëzhgimi i kërkimit historik me një listë të saktë treguesish, portofoli, prezantimi me gojë ose me shkrim, projekti kurrikular etj.).*

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, në përcaktimin e kohës së përshtatshme, në përzgjedhjen e materialeve për vlerësim mësuesi duhet të ketë parasysh:

- Përcaktimin e qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhjen e veprimtarive, që mundësojnë demonstrimin e arritjes së kompetencave
- përdorimin e vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- dallimin qartë të qëllimit të detyrës së zgjedhur për vlerësim.

Vlerësimi i nxënësve duhet të nxjerrë në pah arritjet e tyre, në mënyrë që ata të inkurajohen të mësojnë me më shumë dëshirë. Ai duhet të konsiderohet si një mjet në ndihmë të nxënësve, i cili i ndihmon ata të njohin më mirë aftësitë e tyre në të nxënë, të zhvillojnë e të përdorin talentet dhe aftësitë në mënyra sa më të dobishme. Nxënësit vetë duhet të jenë pjesë e procesit të vlerësimit të arritjeve të tyre.

Me anë të vlerësimit, mësuesi informohet rreth çfarë dhe si po mësojnë nxënësit, ç`ka e ndihmon atë të planifikojë mësimdhënien në vijim dhe të përgatisë materiale ose të rishikojë metodologjinë e mësimdhënies për t'iu përshtatur nevojave të nxënësve. Vlerësimi nga ana e mësuesit duhet të marrë në konsideratë edhe aftësinë e nxënësve për të përcaktuar e arritur objektiva për veten.

a. Vëzhgimi

Mësuesi vlerëson ecurinë e nxënësve duke i vëzhguar ata gjatë punës individuale ose në grup, si dhe ndërveprimin e tyre gjatë veprimtarive të ndryshme në klasë dhe në shkollë. *Mësuesi vëzhgon aspekte, të tilla si:*

- Aftësinë e nxënësve për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të bashkëpunuar në grup;
- ndërveprimet e nxënësve me njëri-tjetrin dhe me të rriturit;
- cilësinë e prezantimit të punimeve;
- interesat, aftësitë ose talentet e veçanta të nxënësve;
- pjesëmarrjen dhe interesin që shprehin nxënësit në veprimtari e aktivitete të ndryshme;
- përgjegjësinë vetjake dhe shoqërore që shfaqin nxënësit;
- përkushtimin dhe këmbënguljen e nxënësve në kryerjen e detyrave të ndryshme;
- nivelin e ndërgjegjësimit të nxënësve për vështirësitë që mund të kenë të tjerët dhe gatishmërinë për t'i ndihmuar ata;
- pyetjet që shtrojnë nxënësit, përgjigjet dhe sugjerimet që nxënësit u japin pyetjeve të mësuesit dhe nxënësve të tjerë;
- sjellje të caktuara, si: aftësitë drejtuese, niveli i vetëbesimit, të shprehurit në mënyrë të drejtpërdrejtë e të hapur, gatishmëria për të përballuar rreziqe, sfida e vështirësi;
- pjekurinë fizike dhe emocionale;
- aftësinë për të vetë-vlerësuar ecurinë në shkollë.

Mësuesi i vëzhgon nxënësit jo vetëm në klasë, por edhe jashtë saj, në aktivitete të ndryshme shkollore, për shembull gjatë lojës, në festime, në ekskursione etj. Mësuesi mund t'i mbajë shënim vëzhgimet për secilin nxënës, në mënyrë që të mund të krijojë një pamje të përgjithshme të ecurisë së zhvillimit të tyre. Kjo i shërben mësuesit edhe për t'ia komunikuar ecurinë e nxënësve prindërve të tyre, ose në raste kur nxënësi ndryshon shkollë, ky lloj vlerësimi mund të ndahet me mësuesin e ri ose me mësuesit pasues të ciklit në vijim.

Vëzhgimi ndihmon sidomos vetë mësuesin, i cili, pasi ka kuptuar nevojat e veçanta të secilit nxënës, duhet të rishikojë metodologjitë e mësimdhënies, në mënyrë që ato të lehtësojnë të nxënit e gjithsecilit. Nëse mësuesi vë re nevoja të veçanta në sjelljen e nxënësve, karakteristike për nxënësit në shkollën e tij, në bashkëpunim me mësuesit e tjerë dhe drejtuesin e shkollës, mund të vendosë të fokusohet më gjatë në atë aspekt të programit, i cili ndihmon në përmbushjen e këtyre nevojave.

b. Detyrat, veprimtaritë praktike dhe testet

Me anë të detyrave të ndryshme që mësuesi u jep nxënësve në klasë, ai arrin të vlerësojë si procesin e punës, ashtu edhe nivelin e të kuptuarit të njohurive të reja nga ana e nxënësve. Me anë të detyrave dhe mësuesi mund të vlerësojë edhe aftësinë e nxënësve për t'i përdorur dijet e marra në situata nga më të ndryshmet. Detyrat dhe veprimtaritë praktike në klasë mund të jenë në grup ose punë individuale.

Një shembull i detyrës në klasë mund të jetë dhënia e një situate, e cila kërkon zgjidhje, ku nxënësit duhet të marrin një vendim së bashku dhe ta mbrojnë atë. Gjatë punës në grup të nxënësve, mësuesi vlerëson demonstrimin e kompetencave dhe aftësinë e gjithsecilit për të punuar në grup. Modelet e veprimtarive praktike dhe vlerësimi i tyte janë dhënë në rubrikën e metodologjisë më sipër.

Testet, si teknikë vlerësimi, rekomandohet të përdoren duke filluar nga klasa e dhjetë e më tej, pasi nxënësit të jenë zhdërvjelltësuar në të shkruar dhe të kenë nisur të marrin njohuri të mirëfillta, të cilat mund të testohen me shkrim. Mësuesi mund t'i përdorë testet me shkrim në fund të një tematike si një teknikë vetëvlerësimi nga ana e nxënësve, pra t'i lejojë ata t'i korrigjojnë vetë testet për të reflektuar e për t'u ndërgjegjësuar mbi aftësitë dhe kufizimet e tyre.

c. Projektet dhe veprimtaritë praktike

Projektet veprimtarive praktike i ndihmojnë nxënësit të përqendrohen në një temë të caktuar të programit, për shembull në njohjen e komunitetit ku ata jetojnë dhe studimin e tij në detaje. Me anë të veprimtarive praktike dhe/ose projektit, mësuesi vlerëson aftësinë e nxënësve për të mbledhur informacion, për ta përpunuar dhe për ta prezantuar atë. Puna me veprimtari dhe projekte mundëson edhe vlerësimin e bashkëpunimit të nxënësve me njëri-tjetrin gjatë punës grup.

d. Paraqitja dhe prezantimi i punimeve

Shpjegimi, paraqitja dhe prezantimi i punimeve të ndryshme që nxënësit realizojnë gjatë lëndës së historisë (detyra në kuadër të veprimtarive praktike dhe projektit) është për mësuesin tregues i aftësive të tyre për të mbledhur informacion, për ta përpunuar dhe për ta paraqitur atë. Gjatë paraqitjes dhe prezantimit të punimeve, nxënësit vlerësohen edhe për shtjellimin e këndvështrimeve të tyre, mbrojtjen e këtyre këndvështrimeve dhe mbajtjen e qëndrimit vetjak ose në grup ndaj një çështjeje të caktuar. Me anë të kësaj teknike vlerësohen kompetencat historike dhe kompetencat kyçe si ajo e komunikimit dhe e të menduarit.

e. Reflektimi dhe vetëvlerësimi nga ana e nxënësve

Kjo teknikë i nxit ata të analizojnë jo vetëm përmbajtjen e asaj që kanë mësuar, por edhe mënyrën se si e kanë përvetësuar këtë njohuri. Në përfundim të një detyre praktike apo projekti, nxënësit udhëzohen të reflektojnë mbi përvojën e tyre të të nxënit, të identifikojnë pikat e forta dhe vështirësitë e hasura gjatë procesit, si dhe të formulojnë hapa të ardhshëm për përmirësim. Vetëvlerësimi mund të realizohet përmes ditarëve reflektues, formularëve të vetëvlerësimit apo diskutimeve të strukturuara në grup. Kjo metodë i ndihmon nxënësit të zhvillojnë ndërgjegjësimin për mënyrën se si mësojnë, të marrin më shumë përgjegjësi për të nxënit e tyre dhe të ndërtojnë kompetencën e të menduarit kritik dhe metakognitiv. Në këtë mënyrë, vlerësimi shndërrohet në një proces dinamik dhe gjithëpërfshirës, që ndihmon si nxënësit ashtu edhe mësuesin të kuptojnë më thellë progresin e arritur dhe nevojat për zhvillim të mëtejshëm.

Pavarësisht zgjedhjes nga ana e mësuesit të teknikave të vlerësimit, qofshin këto formale ose joformale, vlerësimi duhet domosdoshmërish të synojë përmirësimin e përvojave të të nxënit të nxënësve. Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Objektiv i vlerësimit, nuk janë vetëm kompetencat, njohuritë dhe shprehitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike-sociale, në përgjithësi, edhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj. Vlerësimi mbështetet tërësisht në njohuritë e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato njohuri që nuk përshkruhen në program.

6.1 Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit, RN-ve.

Në këtë rubrikë paraqiten disa shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit në tematika të ndryshme.

Tabela 3. Shembull për vlerësimin e RN-ve sipas niveleve të arritjes

Tema: Britania e Madhe gjatë viteve 1945 – 2000 ***Rezultati i të nxënit:*** **Analizon tiparet e sistemit politik, ekonomik dhe shoqëror në Britaninë e Madhe (1945–2000)**			
Niveli i arritjes **Shumë mirë**	**Niveli i arritjes** **Mirë**	**Niveli i arritjes** **Mjaftueshëm**	**Niveli i arritjes** **Dobët**
Nxënësi identifikon dhe analizon në mënyrë të thelluar karakteristikat e sistemit politik (demokracia parlamentare, partitë kryesore), zhvillimet ekonomike (shtetëzimet, neoliberalizmi), dhe transformimet shoqërore (shteti i mirëqenies, lëvizjet rinore, emigracioni), duke përdorur argumente dhe shembuj konkretë.	Nxënësi përshkruan në mënyrë të saktë elementët kryesorë të sistemit politik, ekonomik dhe shoqëror dhe i lidh në mënyrë të përgjithshme me periudhën përkatëse.	Nxënësi përmend disa karakteristika të sistemit politik, ekonomik ose shoqëror, por pa thellim, analizë apo lidhje të qarta mes tyre.	Jep informacion të pjesshëm ose të pasaktë; nuk e lidh zhvillimin e elementeve të përmendura me kontekstin historik.

Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e historisë do të përshkruhen nivelet e arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit sipas tematikave të lëndës.

7 BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe në procesin e të nxënit në lëndën e historisë, ndihmon në konkretizimin e ideve dhe të dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më rezultativ për nxënësit. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa ***mjetet e nevojshme didaktike***, të cilat janë të llojeve të ndryshme, si: *harta historike të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projeksioni, CD, DVD, TIK, etj.* Këto mjete po zënë gjithnjë e më shumë vendin që u takon për konkretizimin e një sërë ngjarjesh historike, të cilat janë vështirë të kuptohen pa një konkretizim audioviziv etj.

Mësuesi i historisë mund të integrojë një gamë të gjerë materialesh për të bërë mësimin sa më të qartë dhe të aksesueshëm për të gjithë nxënësit, si:

- ***Materiale vizuale dhe grafike****:* fotografi historike, harta, linja kohore, piktura murale, dokumente të vjetra, skema konceptuale;
- ***Objekte reale dhe kopje burimesh historike****:* letra, ditarë, monedha, objekte muzeale ose modele të tyre në klasë;
- ***Mjete teknologjike****:* projektorë, kompjuterë, tableta, platforma digjitale (si Wikipedia Edu, Historiana, TimeMaps, Google Arts & Culture), aplikacione për eksplorimin e burimeve multimediale dhe për ndërtimin e ekspozitave virtuale.

Gjatë shpjegimit të temave, mësuesi përdor gjuhë të qartë, fjali të thjeshta dhe një fjalor të përshtatur për moshën dhe nivelin e nxënësve. Ai/ajo zgjedh shembuj konkretë dhe pyetje të hapura që nxisin diskutim dhe reflektim. Përveç tekstit shkollor, përdorimi i fletoreve të punës, burimeve të shtypura dhe digjitale, dokumentarëve edukativë dhe platformave të mësimit ndihmon në pasurimin e përvojës mësimore të nxënësve.

8 PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SI MJET DHE TEKNIKË MËSIMORE NË LËNDËN E HISTORISË

Në arsimin e mesëm të ulët, teknologjia luan një rol të rëndësishëm në përafrimin e nxënësve me përmbajtjen historike përmes mënyrave të reja të të mësuarit. Qasjet ndërdisiplinore dhe përdorimi i teknologjisë në histori ndihmojnë nxënësit të ndërtojnë mendim historik, të analizojnë burime, të ndërtojnë narracione dhe të zhvillojnë ndjeshmëri qytetare. Disa mënyra konkrete se si mund të përdoret teknologjia në mësimin e historisë janë:

- ***Krijimi i linjave kohore digjitale***. Nxënësit përdorin platforma si Canva për të ndërtuar kronologji vizuale të periudhave historike.
- ***Analiza e burimeve historike përmes mjetesh multimediale.*** Përdorimi i videove dokumentare, regjistrimeve audio, faksimileve të dokumenteve për të analizuar dëshmi të së kaluarës.
- ***Eksplorimi i vendeve historike përmes hartave digjitale dhe realitetit virtual***. Aplikacione si Google Earth apo turizmi virtual në muze ndihmojnë nxënësit të "vizitojnë" vende me rëndësi historike.
- **Ndërtimi i projekteve digjitale.** Nxënësit krijojnë prezantime, postera virtualë, ose rrëfime historike digjitale që përfshijnë hulumtim, interpretim dhe krijimtari.
- **Simulime historike dhe role-playing online**. Përdorimi i simulimeve ku nxënësit marrin rolin e personazheve historikë për të debatuar vendime të së kaluarës.
- **Përdorimi i platformave interactive.** Aplikacione si Kahoot, Quizlet apo Wordwall përdoren për rikujtim, testim njohurish apo ndarjen e ideve rreth një teme historike.

Përveç aspekteve didaktike, teknologjia ofron edhe një mundësi për të zhvilluar ***kompetenca digjitale,*** për të nxitur ***punën bashkëpunuese,*** për të ***personalizuar të nxënit*** dhe për të ***stimuluar mendimin kritik dhe kreativitetin*** në raport me përmbajtjen historike. Në këtë mënyrë, përdorimi i teknologjisë dhe materialeve të larmishme në mësimin e historisë nuk është vetëm një zgjedhje metodike, por një domosdoshmëri për ta bërë këtë lëndë funksionale, tërheqëse dhe të lidhur ngushtë me jetën reale dhe sfidat e qytetarisë së sotme.

9 REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Hartimi i programit lëndor të historisë rrjedh nga Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, Kurrikulat Bërthamë, Plani mësimor i Arsimit Bazë dhe Rekomandimet Rek (2001)15 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI. Programi i historisë trajton ngjarjet historike në një kornizë kronologjike e tematike. Vazhdimësia kronologjike mundëson lidhjen e brendshme e të jashtme midis ngjarjeve, periudhave dhe shoqërive të ndryshme, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore. Programi synon që të krijojë te nxënësit bindjen se qytetërimet e sotme janë një vazhdimësi progresive e qytetërimeve të hershme, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të. Ky këndvështrim i ndihmon nxënësit të ndërtojnë perspektivat e një ngjarjeje apo procesi historik ose të parashikojnë trendin e përgjithshëm të këtyre proceseve.

Ruajtja e kronologjisë zbaton kriterin shkencor të zhvillimit të ngjarjeve mbi lidhjen shkak-pasojë dhe vazhdimësinë progresive të rrjedhës historike. Trajtesa tematike shpreh natyrën përzgjedhëse të programit, i cili nuk ka si qëllim të mbulojë të gjitha ngjarjet e historisë, gjë që do të sillte një ngarkesë të panevojshme për nxënësit, por të trajtojë problemet thelbësore, modelet historike që përbëjnë rrënjët e qytetërimeve të sotme. Trajtesa tematike ka pasur parasysh edhe vendosjen e një baraspeshe historike mes kontributeve të krijuara në periudha të ndryshme në lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve pasardhëse, duke shprehur vlerat e tyre në një këndvështrim të barabartë.

9.1 Sqarim për veprimtaritë praktike të sugjeruara dhe orët mësimore të dedikuara për zhvillimin e tyre

Veprimtaritë praktike përbëjnë një pjesë thelbësore të procesit mësimor në lëndën e historisë, pasi ato i japin nxënësit mundësinë të zbatojnë njohuritë e fituara në situata konkrete dhe të zhvillojnë aftësi të të menduarit kritik, analizës historike dhe bashkëpunimit. Ato ndihmojnë në lidhjen e përmbajtjes historike me përvojat personale dhe kontekstin bashkëkohor. Në këtë kuadër, programi i historisë në arsimin e mesëm të lartë përfshin për çdo njësi tematike një ose më shumë veprimtari të sugjeruara, të cilat mund të shërbejnë si ura kalimi nga përmbajtja teorike drejt një përvoje të drejtpërdrejtë mësimore.

- Për çdo tematikë të përfshirë në program, është sugjeruar një numër i caktuar orësh mësimore që përfshin si kohën e nevojshme për zhvillimin e njohurive të reja ashtu edhe kohën e parashikuar për realizimin e veprimtarive praktike të paraqitura në rubrikën "Veprimtari të sugjeruara për tematikën".
- Veprimtaritë praktike janë të sugjeruara, që do të thotë se mësuesit dhe hartuesit e teksteve kanë lirinë t'i përshtatin ose t'i zëvendësojnë ato, në varësi të nevojave të nxënësve, qëllimeve për zhvillimin e kompetencave, si dhe në përputhje me zhvillimet aktuale shoqërore që mund të ndikojnë në procesin mësimor dhe edukativ.
- Rekomandohet që rreth 30% e orëve mësimore të parashikuara për zhvillimin e një tematike t'i dedikohet veprimtarive praktike, ndërsa 70% të fokusohet në zhvillimin e përmbajtjes mësimore dhe ndërtimin e njohurive. Kjo ndarje është orientuese dhe jo detyruese, duke u lënë mësuesve hapësirë për përshtatje, në përputhje me nevojat e nxënësve, orët mësimore dhe kontekstin konkret të mësimdhënies.
- Mësuesi mund t'i zhvillojë veprimtaritë gjatë gjithë trajtimit të tematikës dhe jo vetëm në përfundim të saj. Kjo qasje ndihmon në aktualizimin e njohurive dhe lehtëson procesin e të nxënit, duke e bërë atë më të kuptueshëm dhe më të lidhur me përvojën e përditshme të nxënësit.
- Në rubrikën "Veprimtari të sugjeruara për arsimin e mesëm të lartë (klasat 10-të; 11-të dhe 12-të), për secilën tematikë të programit përkatës, janë propozuar më shumë se një veprimtari praktike, me qëllim që mësuesi të ketë një gamë të larmishme zgjedhjesh. Mësuesi, në varësi të numrit të orëve që ka në dispozicion, zgjedh veprimtarinë ose veprimtaritë që i konsideron më të përshtatshme për përmbushjen e rezultateve të të nxënit dhe për zhvillimin e kompetencave të nxënësve.
- Në rast se mësuesi vëren se tema e një veprimtarie është e gjerë dhe kërkon më shumë se një orë për t'u zhvilluar me nxënësit në klasë, ai përzgjedh një veprimtari nga lista e ofruar dhe e trajton si projekt lëndor duke e shtrirë atë në kohë.

a) Rekomandime për mësuesit

- Të realizohen paralelizma ndërmjet historisë së Shqipërisë dhe historisë së qytetërimeve botërore gjatë zhvillimit të temave të historisë së qytetërimeve botërore, dhe anasjelltas, sipas periudhave përkatëse historike.
- Të lidhin përmbajtjen e historisë me fusha të tjera (shkencë, teknologji, inxhinieri, art, gjuhë, edukatë qytetare, etj.) për të ndihmuar kuptimin e thelluar dhe zbatimin praktik të koncepteve dhe për të kuptuar profesione të ndryshme.

- Të planifikojnë mësimin duke respektuar ritmet dhe nevojat individuale të nxënësve me nevoja të veçanta dhe për fëmijët me aftësi me talente.
- Të nxisin mjedisin bashkëpunues, të sigurt, ku nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të mbështetur në zhvillimin socio emocional.
- Të sigurojnë akses të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë ata nga pakicat kombëtare dhe grupe të margjinalizuara.
- Të përfshijnë platforma digjitale interkative për mësimin e historisë.
- Të sigurojnë dhe të përdorin librat origjinal të mësuesit si pjesë e paketës së teksteve shkollore.
- Të sigurojnë dhe të përdorin udhëzuesit kurrikularë të lëndës së historisë.
- Të përdorin materialet burimore për zbatimin e programit.

Rekomandime për autorët e teksteve shkollore

- Të përshtatin në mënyrë cilësore tekstet shkollore duke reflektuar të gjitha përditësimet më të fundit.
- Të realizohen paralelizma ndërmjet historisë së Shqipërisë dhe historisë së qytetërimeve botërore gjatë zhvillimit të temave të historisë së qytetërimeve botërore, dhe anasjelltas, sipas periudhave përkatëse historike.
- Të përfshijnë platforma digjitale interkative për mësimin e historisë, në tekstet shkollore.
- Të përfshijnë burime të ndryshme për mësimin praktik të historisë.
- Të citojnë burimet e përdorura si pjesë e tekstit shkollor.
- Të sigurojnë materialet burimore edhe digjitale për zbatimin e tekstit shkollor.
- Të lidhin konceptet historike me fusha të tjera dhe me situata të jetës reale, në tekstet shkollore.
- Të përfshijnë në tekstet shkollore veprimtari dhe detyra që promovojnë mendimin kritik, zgjidhjen e problemeve dhe krijimtarinë.
- Të krijojnë hapësirë në tekstet shkollore për shembuj dhe ushtrime që nxisin orientimin për karrierë, përmes profesioneve ku historia luan rol.
- Të sigurojnë që tekstet të kenë qasje gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme për moshën, duke marrë parasysh diversitetin kulturor dhe aftësitë e ndryshme të nxënësve.

Rekomandime për hartuesit e testeve kombëtare

- Të sigurojnë që testet të përmbajnë jo vetëm pyetje që matin njohuritë, por edhe pyetje me situate që integrojnë qasje ndërdisiplinore, që nxisin të menduarit logjik, të menduarin kritik dhe krijues, jo thjesht memorizimin.
- Të përfshijnë pyetje që lidhin konceptet historike me koncepte të lëndëve apo fushave të tjera.
- Të kenë parasysh nivelin e diversitetit të nxënësve, duke përfshirë pyetje që janë të qarta dhe të kuptueshme për të gjithë, pavarësisht sfondit kulturor ose gjuhësor.
- Të hartojnë modele të testeve kombëtare në mënyrë që të punohen nga nxënësit gjatë viteve të shkollimit.

b) Rekomandime për vlerësuesit e jashtëm

- Të vlerësojnë mësuesit për cilësinë e mësimdhënies në zbatim të programit dhe rubrikave të këtij programi.
- Të vlerësojnë mësuesit për përdorimin e situatave nga jeta reale në përvetësimin e koncepteve historike.
- Të vlerësojnë përfshirjen e situatave nga jeta reale dhe çështjeve aktuale shoqërore për zhvillimin e mësimit të historisë dhe të projekteve kurrikulare.
- Të vlerësojnë përdorimin e niveleve të arritjes për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.
- Të vlerësojnë organizimin e punës në grupe dhe bashkëpunimin në veprimtaritë mësimore.
- Të vlerësojnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe zhvillimit të veprimtarive praktike gjatë zhvillimit të orëve mësimore të historisë.
- Të nxisin mësuesit që të krijojnë mjedise të përshtatshme për personalizimin e të nxënit dhe për mbështetjen e diversitetit në klasë.
- Të vlerësojnë se si mësuesit promovojnë mirëqenien socio-emocionale të nxënësve përmes mënyrës së komunikimit dhe aktiviteteve në orën e historisë.
- Të vlerësojnë që mësuesit garantojnë qasje të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë pakicat kombëtare dhe grupet vulnerabël.

c) Rekomandime për prindërit

- Të inkurajojnë fëmijët që të kuptojnë rëndësinë e historisë jo vetëm për notë, por për jetën e përditshme.
- Të bashkëpunojnë me shkollën për të ndihmuar fëmijët në pjesëmarrjen në projekte dhe konkurse që lidhen me historinë.

- Të promovojnë një qëndrim pozitiv ndaj mësimit të historisë, duke theksuar rëndësinë e saj për të kuptuar zhvillimet shoqërore dhe për të mësuar nga gabimet e të shkuarës.
- Të sigurojnë që fëmijët ndihen të mbështetur emocionalisht dhe që mësimi i historisë zhvillohet në një mjedis të qetë, të barabartë dhe motivuese për fëmijët e tyre.
- Të kuptojnë rëndësinë e historisë si bazë për profesione të ndryshme dhe të eksplorojnë interesat personale në këtë drejtim.

10 NDRYSHIMET E PROGRAMIT TË HISTORISË, KLASA X

Programi i historisë është përditësuar me qëllim që të jetë më gjithëpërfshirës dhe të përgjigjet më mirë ndaj nevojave të një shoqërie demokratike dhe të ndërlidhur globalisht. Ky përditësim thekson rëndësinë që historia t'i kushtojë zhvillimeve të reja shoqërore, ndryshimeve klimatike dhe mjedisore, zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe bashkëjetesës paqësore në një botë gjithnjë e më komplekse. Ndryshimet kryesore të ndërmarra në program synojnë përmbushjen e qëllimeve kombëtare të arsimit parauniversitar, duke zbatuar rekomandimet e Këshillit të Evropës për mësimdhënien e historisë në shekullin XXI dhe duke forcuar qasjen e bazuar në kompetenca, me fokus në dy drejtime kryesore:

- Përditësime në aspektet përmbajtjesore të lëndës së historisë përmes temave të reja të veprimtarive praktike, perspektivave ndërdisiplinore dhe ndërlidhjes me aktualitetin shoqëror, mjedisor dhe teknologjik.
- Përditësime në aspektet pedagogjike dhe metodologjike me theks në qasjen e bazuar në kompetenca, mësimin aktiv, përfshirjen gjithëpërfshirëse dhe përdorimin e teknologjisë si mjet didaktik.

10.1 Përditësime në aspektet përmbajtjesore të lëndës së historisë

Në programin e lëndës së historisë për klasën e dhjetë janë bërë disa ndryshime në përmbajtje, të cilat përfshijnë:

1. Përditësimin e koncepteve kyçe historike për të harmonizuar terminologjinë me praktikat bashkëkohore të mësimdhënies dhe dokumentet ndërkombëtare të kurrikulës, duke ofruar një formulim më të qartë dhe funksional që lehtëson kuptimin dhe përdorimin e koncepteve nga nxënësit. Përfshirja e termave si "diversiteti" dhe "empatia historike" pasqyron zhvillimet e reja në didaktikën e historisë. Përditësimi i

koncepteve kyçe historike, paraqitet në tabelën më poshtë:

Koncepte kyçe historike	
Në versionin e mëparshëm	**Në versionin e përditësuar**
Kuptimi kronologjik	Kronologjia
Ndryshimi dhe vazhdimësia	Ndryshimi dhe vazhdimësia
Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare	Diversiteti
-	Empatia historike
Rëndësia historike	Rëndësia historike

2. Zëvendësimin e termave "*para Krishtit*" dhe *"pas Krishtit"* me "*para erës sonë (p.e.s.)" dhe "pas erës sonë (e.s.)"* për një përdorim më neutral dhe gjithëpërfshirës.
3. Janë përditësuar temat e veprimtaritë praktike dhe rezultatet përkatëse të të nxënit, duke pasuruar përmbajtjen me elementë që theksojnë: zhvillimin e kompetencave historike, mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve, integrimin e historisë së Shqipërisë, vlerësimin e identitetit kombëtar, trashëgiminë kulturore dhe ndikimet ndërkulturore; trajtimin e rreziqeve natyrore, pandemive, krizave ekonomike e politike, rolin e historisë në përballimin e sfidave bashkëkohore; rolin e zhvillimeve teknologjike në transformimin e jetës shoqërore dhe realitetit aktual.

10.2 Përditësimet në aspektin metodologjik

- Përditësimi i kompetencave kyçe dhe i rezultateve të të nxënit, të përshtatura për klasën e dhjetë.
- Përditësimi i rezultateve të të nxënit për konceptet kyçe dhe kompetencat historike të përshtatura për klasën e dhjetë .
- Përditësimi i temave ndërkurrikulare, me qëllim trajtimin e çështjeve prioritare përmes integrimit të njohurive nga lëndë të ndryshme, duke përforcuar kështu mësimin gjithëpërfshirës dhe zhvillimin e aftësive të mendimit kritik dhe analizës nga perspektiva të ndryshme.

- Harmonizimi i metodologjisë me rekomandimet e Këshillit të Evropës për mësimdhënien e historisë në shekullin XXI.
- Ofrimi i një metodologjie më të përshtatshme dhe të balancuar në zhvillimin e kompetencave historike, zhvillimin e mendimit kritik, krijues dhe zgjidhjen problemore, duke përfshirë të nxënit e personalizuar, të nxënit socio-emocional, përdorimin e teknologjisë etj.
- Përfshirja e shembujve të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve
- Përditësimi i vlerësimit të nxënit bazuar në nivelet e arritjes sipas rezultateve të të nxënit.
- Nxitja e ndërgjegjësimit për diversitetin, bashkëjetesën dhe dialogun ndërkulturor si elemente themelore të edukimit për jetesën në një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe demokratike.
- Përqendrimi në përgatitjen e nxënësve për një qytetari aktive, kritike dhe të ndërgjegjshme në një botë dinamike dhe në ndryshim të vazhdueshëm.
- Përditësimi i temave të veprimtarive praktike dhe i rezultateve përkatëse të të nxënit me elementë që theksojnë:
  - ✓ identitetin kombëtar, patriotizmin, trashëgiminë kulturore dhe ndikimet ndërkulturore;
  - ✓ rreziqet natyrore, pandemitë, krizat ekonomike dhe politike, duke theksuar rolin e historisë në kuptimin dhe përballimin e sfidave bashkëkohore;
  - ✓ rolin e zhvillimeve teknologjike në transformimin e jetës shoqërore dhe realitetit bashkëkohor, si në të tashmen ashtu edhe në perspektivën ardhshme;
  - ✓ përshtatje të përmbajtjes dhe metodave për pakicat kombëtare, nxënësit me nevoja të veçanta, si dhe detyra të avancuara për nxënësit e talentuar.

Të gjitha ndryshimet synojnë të përmirësojnë qartësinë konceptuale, saktësinë historike dhe koherencën edukative, në përputhje me qëllimet formuese të lëndës.